



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 349/7 prot.

Tiranë, më 07. 08. 2025

V E N D I M

Nr. 179, datë 07. 08. 2025

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi², mori në shqyrtim ankesën nr. 42 Regj., datë 20.02.2025, të paraqitur nga I. I., kundër Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH) dhe Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) Tiranë, me pretendimin për diskriminim, për shkak të “moshës dhe çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës të I. I., në mes të tjerash, parashtrohet se: “Kam shërbyer si ushtarak (Oficer) në Forcat e Armatosura (FA), nga data 04.11.1970 deri më 30.09.1992. Gëzoj detyrimet dhe të drejtat që burojnë nga Statusi i Ushtarakut të FA të Republikës së Shqipërisë dhe kuadrit ligjor në zbatim të tij. Për shkak të reformës në ushtri, më 30.09.1992 nxirrem në rezervë. Nga kjo datë deri më 21.12.1995 jam trajtuar me pagesë kalimtare nga Ministria e Mbrojtjes ku shërbeja. Pas kësaj date, më 01.01.1996 nxirrem në lirim për të përfutur pension të parakohshëm.

Në bazë të ligjit nr. 8087/1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të FA të RSH”, i ndryshuar, më lindi e drejta e trajtimit me pension të parakohshëm për vjetërsi të shërbimit të ushtarakut, ku ligjvënësi ia ngarkon ISSH-së përlllogaritjen, caktimin dhe pagesën e pensionit. Organi vartës i tij, DRSSH Tiranë, edhe pse i dërgohen dokumente me të dhëna personale të dërguara nga Ministria e Mbrojtjes, me Vendimin nr. 1477, datë 17.02.2000, më cakton pension të parakohshëm në masën 8000 lekë, me të drejtë fillimi më 01.01.1999 dhe mbarim më datë 17.06.2006.

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Për shkelje të dispozitave lidhur me masën e pensionit të parakohshëm, jam ankuar gjyqësisht. Çështja ka kaluar në të gjitha shkallët, ende e papërfunduar, qysh nga viti 2012 (aktualisht është për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese). Që të gjitha gjykatat e kanë pranuar pjesërisht padinë, duke më nxjerrë në të gjitha rastet kreditor dhe DRSSH-në si debitore, duke e detyruar atë të më kthejë lekët e mbajtura padrejtësisht, në 12 vite.

Sipas praktikës së DRSSH, në datën 17.06.2011, ndërpret pensionin e parakohshëm dhe mbi bazën e dokumenteve të dërguara përsëri nga Ministria e Mbrojtjes, por përkundër tyre, me vendim nr. 3882, datë 25.07.2011 dhe nr. 187, datë 15.12.2011, më cakton respektivisht pension pleqërie në masën 12.191 lekë dhe pension suplementar në masën 9863 lekë. Për mosrespektim të kërkesave thelbësore të ligjit material i kam kundërshtuar administrativisht, në DRSSH dhe ISSH dhe pas 2,5 vitesh, dhe në ballafaqim me ISSH, me Vendimet datë 10.10.2013 dhe datë 11.10.2013, u vendosën në masën maksimale, sikurse parashikonte ligji.

Edhe për kohën e daljes në pension pleqërie, DRSSH ka shkelur ligjet materialë nr. 8087/1996, “Për ushtarakët”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 7703/1993 “Për sigurimet shoqërore”, i ndryshuar, duke më nxjerrë dy vjet me vonesë, pra jo në datën 17.06.2009 (sipas ligjit), por në datë 17.06.2011. Përsëri për shkelje ju drejtova gjykatës. Pas 8 vitesh në proces gjyqësor, përfundimisht Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me Vendim nr. 1885, datë 11.11.2024, njohu datën 17.06.2009, si datë të parashikuar nga ligji specifik për të drejtën e përfitimit të pensionit të plotë të pleqërisë dhe atij suplementar, si derivat i tij. Ndërkohë me vendim detyron DRSSH-në Tiranë të më kthejë shumat e papaguara për periudhën 2 vjeçare 17.06.2009-17.06.2011. Gjykata cilësoi se ky vendim është titull ekzekutiv, i ekzekutueshëm nga përmbarimi gjyqësor.

Përfaqësuesja juridike e DRSSH Tiranë, pas shpalljes së vendimit, më kërkoi të mos e çoja vendimin për ekzekutim në Zyrën e Përmbarimit Gjyqësor, pasi do ta ekzekutojë vetë vendimin e kundërligjshëm, që pa asnjë shkak e arsye ligjore, më pezulloi marrjen e pensionit të plotë të pleqërisë dhe atij suplementar periodik mujor, si i vetmi burim financiar, pa asnjë të ardhur tjetër, për muajin janar dhe shkurt 2025, pension që e kam marrë rregullisht qysh nga datat 17.06.2011 e deri në dhjetor 2024.

Në datën 7 janar 2025, shkova të marrë pensionin në Postën Shqiptare nr. A-24, dhe nuk m'u dha, ku nëpunësja shpërndarëse më bëri me dije se emri im nuk figuronte në listë pagesat e dërguara nga DRSSH. Bëra një ankim me postë elektronike në DRSSH dhe ISSH, duke cilësuar këtë veprim haptazi të padrejtë dhe të kundërligjshëm, pa asnjë bazë ligjore, deri alogjike. Madje në takim me punonjës të këtyre autoriteteve, më premtuan zgjidhje por çështja nuk u zgjidh...

Pas ankimeve të përsëritura në ISSH dhe DRSSH, në datën 4 shkurt 2025, m'u mundësua marrja e vetëm pensionit të pleqërisë, me të cilin lava borxhin e Janarit. Po nuk m'u dha pensioni suplementar i ushtarakut, i cili pa asnjë arsye ligjore e logjike mbahet peng nga DRSSH, kur, sipas ligjit, ka lidhje dhe është derivat i pensionit të pleqërisë...Kam bërë kërkesë Drejtorit të DRSSH dhe Koordinatorit, pranë DRSSH por nuk kam marrë asnjë përgjigje. ”.

Subjekti ankues ka kërkuar, ndër të tjera, nga Komisioneri:

“Konstatimin e diskriminimit të ankuesit, nga DRSSH Tiranë, për shkak të moshës dhe çdo shkak tjetër. Konstatimin e diskriminimit në formën e viktimizimit, me sjellje dhe veprime tendencioze të DRSSH, për shkak të ankimeve dhe padive të bëra kundër saj në gjykatë, e në media, lidhur me kohën dhe masën e pensionit.

Detyrimin e DRSSH Tiranë që të marrë masa për të ndërprerë në mënyrë të menjëhershme veprimet ndaj tij dhe kthimin sa më shpejt të të gjithë pagesave të pensionit suplementar që i janë ndaluar.

Detyrimin e DRSSH Tiranë që të marrë masa të shpejta dhe efektive për ndërgjegjësimin e punonjësve, për mospërsëritjen në të ardhmen të sjelljeve dhe të veprimeve të tilla.”

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, germa a, të LMD, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqet e pretenduara nga pala ankuese, duke përcaktuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: *“1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”*

Në Kreun III, të LMD parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person*

tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën Nr. 349/1 prot., datë 05.03.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga ISSH dhe DRSSH Tiranë, lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
 - Informacion dhe argumente lidhur me pretendimet e ngritura nga ana e I. I..
 - Cilat janë arsytet që ankuesit i është ndaluar pagesa e pensionit të pleqërisë dhe atij suplementar në muajt Janar dhe Shkurt 2025? A janë evidentuar, problematika të ngjashme, si në rastin e ankuesit? Nëse po, të citohet numri i tyre.
 - Çdo informacion tjetër që ju do të gjykohet i arsyeshëm se do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

Në përgjigje përsa më lart, DRSSH Tiranë, përmes shkresës³ nr. 29636/27 prot., datë 09.04.2025 dhe ISSH përmes shkresës⁴ nr. 36212/2 prot., datë 08.04.2025, mbajtën të njëjtin qëndrim duke informuar Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, lidhur me parashtrimet e tyre sa i përket ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, duke sqaruar ndër të tjera se: “*...Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, në zbatim të ligjit nr. 8087/1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakeve të Forcave të Armatosura”, të ndryshuar, me vendimin për caktim pensioni nr. 1477, datë 17.02.2000, i ka caktuar I. I. pension të parakohshëm, me të drejtë fillimi nga data 01.01.1999 dhe mbarim në datë 17.06.2011.*

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, në zbatim të nenit 31, 32, 92, të ligjit nr. 7703/1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me vendimin për caktim pensioni nr. 3822, datë 25.07.2011, i ka caktuar I. I. pension të plotë pleqërie me 40 vite e 5 muaj periudhë sigurimi, me të drejtë pagese nga data 17.06.2011, me masë fillestare 12.191 Leke në muaj.

Pensioni është rillogaritur në datë 20.09.2011, me pagat referuese sipas funksionit të kryer ndër vite, të përcaktuara në VKM nr. 561, datë 12.08.2005 “Për caktimin e pagave referuese për

³ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 349/3 prot., datë 10.04.2025.

⁴ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 349/4 prot., datë 11.04.2025.

llogaritjen e pensioneve”, lloji i punës “Oficer”, me koeficientët e vitit 2011, me bazë mesatare mujore 25.378 Lekë, pagë neto 26.301 Lekë, me periudhë sigurimi 41 vite e 9 muaj dhe me masë pensioni 19.726 Lekë në muaj.

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 793 date 24.09.2010 “Për zbatimin e ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, në Republikën e Shqipërisë”, pensioni i pleqërisë është rishqyrtuar me datë fillimi 17.06.2011, me masë pensioni 21,380 Lekë në muaj. Përfitimi është llogaritur që nga momenti që I. I. ka plotësuar kushtet për përfitim, në zbatim të nenit 32 të ligjit nr. 7703/1993, të ndryshuar, ku parashikohet:

- 1. Pensioni mujor i pleqërisë përbëhet nga një shumë bazë dhe nga një shtesë.*
- 2. Shuma bazë e pensionit që u jepet gjithë personave të siguruar, duhet të sigurojë të paktën një standard jetese minimal, i indeksuar çdo vit në lidhje me indeksin e çmimeve të disa mallrave të zgjedhura, të përcaktuara në rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.*
- 3. Shtesa që u jepet personave të punësuar, do të jetë 1 për qind për vit sigurimi shumëzuar me bazën mesatare të vlerësueshme që personat e siguruar kanë arritur nëpërmjet kontributeve. Këshilli i Ministrave të indeksojë çdo vit bazën e vlerësimit individual në lidhje me zhvillimin e kontributeve mesatare të paguara në këtë vit.*
- 4. Shuma e përgjithshme e pensionit do të jetë jo më shumë se dyfishi i shumës bazë, ose 75 për qind e pagës neto mesatare të 3 viteve rresht të 10 viteve të fundit të punës të personit të siguruar, cila të jetë më e vogël.*

Paga neto mesatare e 3 viteve të njëpasnjëshme të 10 viteve të fundit të punës së personit të siguruar, indeksohet çdo vit, sipas rregullave të indeksimit të bazës së vlerësuar.

Bazuar në pikën 6, të VKM-së nr. 474, datë 30.06.2010 “Për rritjen e pensioneve”, pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në mbështetje të ligjit nr. 7703/1 993, të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të këtij ligji, që kanë datë fillimi nga 01.07.2010 e në vazhdim, nuk caktohen më pak se 10,690 Lekë në muaj dhe më shumë se 21,380 Lekë në muaj. Masa e pensionit të I. I. është caktuar në nivelin maksimal të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Pensioni i pleqërisë dhe pensioni suplementar janë rritur dhe indeksuar sipas përcaktimeve VKM-së nr. 348, datë 12.06.2018 “Për indeksimin e pensioneve” dhe nga data 01.07.2018, I. I. ka përfitur:

- Pension pleqërie në masën 26. 759 Lekë në muaj.*
- Kompensim sipas VKM-së nr. 138, datë 31.03.1994 “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndët djegëse”, në masën 300 Lekë.*
- Kompensim sipas VKM-së nr. 471, datë 15.07.1996 “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm”, në masën 150 Lekë.*
- Kompensim sipas VKM-së nr. 565/2006, të ndryshuar, në masën 640 Lekë.*
- Kompensim sipas VKM-së nr. 8/2015, të ndryshuar, në masën 648 Lekë.*
- Pension suplementar pleqërie në masën 13.332 Lekë në muaj.*

- Gjithsej: 41.879 Lekë në muaj.

Në lidhje me pretendimin për rishikimin e datës së daljes në pension, në kushtet e kategorisë së dytë të punës, të parashikuara në nenin 92 të Ligjit nr. 7703/1993, të ndryshuar, I. I. është informuar se nuk ka plotësuar kushtet për këtë lloj përfitimi. Referuar datëlindjes së I. I. 17.12.1946, si dhe nenit 92 të ligjit nr. 7703/1993, të ndryshuar, mosha për përfitim pensioni pleqërie në kushtet e kategorisë së dytë të punës, është mosha 62 vjeç e 6 muaj (kusht që e plotëson në datën 17.06.2009) dhe duhet të ketë 35 vite periudhë sigurimi (të cilën e plotëson), nga të cilat 26 vite e 4 muaj periudhë pune e kategorisë së dytë sipas parashikimeve të VKM nr. 526, datë 20.12.1958 “Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni”, të ndryshuar. (kusht që nuk e plotëson).

Periudhat e punës të I. I., në kushtet e kategorisë së dytë të punës, sipas VKM nr. 526/1958, të ndryshuar, janë si më poshtë:

- 01.09.1966 - 21.12.1967 Mësues në Seksionin e Arsimit Gjirokastër;
- 01.12.1970 - 01.10.1992 Oficer aktiv në Ministrinë e Mbrojtjes.

Gjithsej 23 vite, 1 muaj e 20 ditë, periudhë sigurimi, nga 26 vite e 3 muaj që kërkohet për këtë përfitim.

Periudhat e tjera të sigurimit janë:

- Shërbim i detyrueshëm ushtarak 22.12.1967 - 30.11.1970;
- Periudha e trajtimit me pagesë kalimtare 01.10.1992 - 31.12.1995;
- Periudha e trajtimit me pension të parakohshëm 01.01.1999 - 17.06.2011.

Asnjë nga këto periudha nuk bën pjesë në punët e kategorisë së dytë, të pasqyruara në VKM nr. 526, datë 20.12.1958 “Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni”, të ndryshuar.

E drejta e gëzimit të një përfitimi, lind kur plotësohen të gjitha kriteret e përcaktuara në dispozitat ligjore përkatëse. I. I. ka plotësuar dy nga tre kriteret që kërkohen, moshën dhe periudhën e përgjithshme të sigurimit dhe nuk ka plotësuar periudhën e sigurimit në kushtet e kategorisë së dytë të punës. Për rrjedhojë, nuk ka përfituar pension pleqërie në kushtet e kategorisë së dytë.

I. I. nuk ka qenë dakord me përfitimin e caktuar dhe ka vijuar me ankimin administrativ. Komisioni Rajonal i Ankimit pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, me vendimin nr. 32, datë 11.03.2016, ka vendosur të rrëzojë kërkesën për caktimin e pensionit të pleqërisë në kushtet e kategorisë së dytë të punës, që nga data 17.06.2009 deri në 17.06.2011. Komisioni Qendror i Ankimit pranë ISSH-së, me vendimin nr. 946, datë 20.06.2016, ka vendosur të rrëzojë kërkesën për caktimin e pensionit të pleqërisë në kushtet e kategorisë së dytë të punës dhe të lërë në fuqi vendimin e DRSSH-së Tiranë dhe vendimin nr. 32, datë 11.03.2016, të Komisionit Rajonal të Ankimit pranë DRSSH-së Tiranë.

Neni 86 i ligjit nr. 7703/1993, të ndryshuar, parashikon se:

1. Ankimi kundër vendimeve të përfitimeve bëhet në Komisionin e Ankimit pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore. Ankimi, në këto raste, depozitohet pranë sporteleve të shërbimit, në përputhje me legjislacionin që rregullon mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel.

2. Ankimi kundër vendimeve të Komisionit të Ankimit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore bëhet në Komisionin e Ankimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore;

3. Ankimet e zgjidhura në mënyrë të pafavorshme bëhen në Gjykatë, vendimi i të cilës është përfundimtar;

Në vijim I. I. i është drejtuar gjykatës dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 762, datë 28.02.2017, ka vendosur: Rrëzimin e padisë së paditësit I. I. Kundër këtij vendimi I. I., si palë paditëse, ka bërë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, me shkresën nr. 29636/3 prot, datë 04.12.2024, është njoftuar nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë për vendimin nr. 1885, datë 11.11.2024, me palë paditëse I. I. dhe të paditur: DRSSH Tiranë dhe ISSH, ku është vendosur:

- Ndryshimin e vendimit nr. 762, datë 28.02.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- Pranimin pjesërisht të padisë.
- Ndryshimin pjesërisht të vendimit nr. 3882, datë 25.07.2011 dhe të vendimit nr. 187, datë 15.12.2011 të DRSSH Tiranë lidhur me datën e fillimit të së drejtës për pension pleqërie dhe suplementar nga data 16.06.2011 në datën 17.06.2009.
- Detyrimin e palës së paditur DRSSH Tiranë ti paguajë paditësit diferencat e pensionit të pleqërisë dhe atij suplementar të indeksuara sipas viteve për periudhën 17.06.2009-16.06.2011.
- Rrëzimin e padisë, për pjesën tjetër si të pabazuar në prova dhe në ligj.
- Ky vendim përbën titull ekzekutiv dhe është i ekzekutueshëm nga përmbaruesi gjyqësor.
- Kundër këtij vendimi lejohet rekurs brenda 30 ditëve në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Në zbatim të vendimit të sipërpërmendur, Dega e Përfitimeve pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, me vendimin për rishqyrtim pensioni me nr. 3882/4, dt. 10.12.2024, ka përllogaritur diferencat e pensionit të pleqërisë nga data 17.06.2009 - 16.06.2011, në vlerën totale 503.705 lekë.

Gjithashtu, sipas vendimit për rishqyrtim pensioni nr. D, datë 23.12.2024, është përllogaritur pensioni suplementar dhe ka rezultuar se me vendim nr. 1477, datë 17.02.2000, I. I. ka përfituruar pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi me të drejtë pagese nga data 01.01.1999-17.06.2011. Për periudhën 17.06.2009-16.06.2011, që është trajtuar me pension të parakohshëm ka përfituruar shumë 300.792 Lekë dhe në kushtet që gjykata i ka njohur të drejtën e pensionit suplementar të pleqërisë për periudhën 17.06.2009-16.06.2011, janë llogaritur diferencat në vlerën 251.580 lekë. Është bërë diferenca kredi-debi dhe ka rezultuar debitor në vlerën 49.176 Lekë.

Pas kryerjes së të gjithë procedurës nga Dega e Përfitimeve pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, për zbatimin e vendimit të sipërcituar, dosja është dërguar në Drejtorinë e Inspektimit të Përfitimeve pranë Institutin e Sigurimeve Shoqërore, për vlerësimin e ligjshmërisë të caktimit të përfitimit.

Në procesin e vlerësimit të dosjes, janë hasur vështirësi për zbatimin e titullit ekzekutiv pasi gjykata në arsyetimin e vendimit është shprehur në mënyrë kontradiktore si më poshtë:

“Në analizë përfundimtare të ligjit dhe fakteve të provuara në gjykim, Kolegji vlerëson se aktet administrative objekt gjykimi: Vendimi nr. 3882, datë 25.07.2011 dhe vendimi nr. 187, datë 15.12.2011, të DRSSH-së Tiranë, duhet të ndryshohen pjesërisht lidhur me datën e fillimit të së drejtës për pension pleqërie dhe suplementar nga data 16.06.2011, në datën 17.06.2009. Për pasojë, pala e paditur DRSSH Tiranë, ka detyrimin t’i paguajë paditësit diferencat e pensionit të pleqërisë dhe suplementar të indeksuara sipas viteve për këtë periudhë (17.06.2009 - 16.06.2011). Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se pretendimi i dytë i paditësit se duhet t’i caktohet pension i kategorisë së dytë dhe jo i kategorisë të tretë, siç i është caktuar nga DRSSH Tiranë, është i papabazuar në ligj dhe si i tillë duhet rrëzuar”.

Gjykata në dispozitivin e vendimit ka vendosur: “Detyrimin e palës së paditur DRSSH Tiranë t’i paguajë paditësit diferencat e pensionit të pleqërisë dhe atij suplementar të indeksuara sipas viteve për periudhën 17.06.2009-16.06.2011”. Referuar nenit 92 të ligjit nr. 7703/1993, të ndryshuar dhe nenit 23 të ligjit nr. 10142/2009, rezulton se data e lindjes së të drejtës për pension të kategorisë së tretë është data 16.06.2011, ndërsa gjykata ka vendosur t’i paguhen diferencat nga data 17.06.2009, edhe pse pretendimi për pension të kategorisë së dytë në fakt e ka rrëzuar dhe pensioni mund të fillonte nga kjo datë vetëm nëse ky pretendim do të ishte pranuar. Në këto kushte, dosja është kthyer me shkresë nr. 12834/1 prot., datë 23.01.2025, nga Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve, me detyrë që DRSSH Tiranë të bëjë kërkesë për sqarim dhe interpretim vendimi pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, me kërkesën e datës 23.01.2025 “Kërkesë për sqarim interpretim vendimi”.

Ndërkohë, I. I. i është drejtuar zyrës përmbarimore E.G BAILIFF SERVICE, e cila me shkresën nr. 762/1 prot., datë 03.03.2025 “Lajmërim për Ekzekutim të Detyrueshëm”, njoftuar në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë me nr. 29636/17 prot., datë 06.03.2025, ka kërkuar ekzekutimin e vendimit nr. 1885, dt. 11.11.2024, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, me shkresën nr. 29636/19 prot., datë 11.03.2025, i ka kthyer përgjigje zyrtare, duke i vënë në dispozicion përmbaruesit gjyqësor Enuar Merko të gjithë praktikën e mbajtur nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, mbi mënyrën e përllogaritjes së diferencave të pensionit të pleqërisë dhe suplementar dhe për “Kërkesën për sqarim dhe interpretim vendimi”, drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 40, dt. 12.02.2025, ka vendosur: Rrëzimin e kërkesës së Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, vendim për të cilin ka marrë dijeni me njoftimin nr. 29636/20 prot., datë 11.03.2025. DRSSH Tiranë me shkesën nr. 29636/21 prot., datë 12.03.2025, ka ridërguar dosjen përsëri për certifikim. Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve pranë ISSH-së, ka certifikuar dosjen e përfitimit të I. I. dhe e ka dërguar pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, më datë 22.03.2025 për të vijuar me procedurat.

Diferencat e pensionit të pleqërisë nuk i kanë kaluar I. I. në arkën postare ku tërheq pensionin, pasi siç kemi shpjeguar më lartë, Përmbaruesi Gjyqësor Enuar Merko ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm dhe në sekuestrimin e llogarive bankare.

Në lidhje me pyetjen tuaj se cilat janë arsyet e ndalesës së pagesës për muajt Janar, Shkurt 2025 dhe nëse janë evidentuar nga ana jonë problematika të ngjashme si në rastin e I. I., ju bëjmë me dije se:

Germa “a” e pikës 4 të nenit 104 “fillimi dhe përfundimi i pasojave juridike të aktit administrativ”, të Kodit të Procedurave Administrative, parashikon se:

“Një akt administrativ sjell pasoja juridike:

a) për sa kohë nuk është anuluar apo shfuqizuar, kryesisht apo si rezultat i ushtrimit të mjeteve ligjore administrative ose gjyqësore”.

Vendimi për rishqyrtim pensioni me nr. 3882M, datë 10.12.2024, është një akt i ri administrativ, i dalë në zbatim të një vendimi gjyqësor dhe në kuptim të nenit të sipërpërmendur, sjell pasoja juridike për vendimin e mëparshëm të caktimit të pensionit, duke e shfuqizuar atë.

Referuar rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, kryen kontrollin e plotë për çdo rast përfitimi që administron sistemi i sigurimeve shoqërore. Ky kontroll konsiston në kontrollin e plotë të të gjitha përfitimeve të caktuara për herë të parë dhe për përfitimet e rishqyrtuara, nga DRSSH/DSSH-të, me qëllim që këto përfitime të jenë të bazuara dhe të mbështetura në dispozita ligjore.

Në zbatim të vendimit të gjykatës DRSSH Tiranë ka rishqyrtuar pensionin në datën 10.12.2024 dhe në zbatim të procedurave administrative për caktimin dhe rishqyrtimin e përfitimeve, dosja është përcjellë pranë Drejtorisë së Inspektimit të Përfitimeve pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për kontrollin dhe certifikimin e vendimmarrjes për rishqyrtimin e pensionit.

Sa më sipër, dosja e përfitimit ka qenë në proces shqyrtimi administrativ dhe vonesa e pagesës së përfitimit për muajt Janar dhe Shkurt, ka ardhur si pasojë e kërkesës së bërë nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë për sqarim interpretim të vendimit të gjykatës, e cila ishte një kërkesë e domosdoshme, për shkak të kontradiktoritetit të vendimit, të sqaruar si më sipër. Kanë qenë kushtet specifike si pasojë e vendimit të gjykatës që kanë sjellë nevojën për sqarim interpretim vendimi dhe nga strukturat e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe DRSSH Tiranë nuk ka pasur asnjë trajtim të diferencuar në lidhje me procedurën e ndjekur dhe në asnjë moment Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë nuk është bërë pengesë për ekzekutimin e vendimit të gjykatës dhe e ka ndjekur procedurën pa vonesa dhe në respekt të dispozitave ligjore...”.

2. Në vijim, përmes e-mail-eve datë 10.04.2025 dhe 14.04.2025, Komisioneri vuri në dispozicion të subjektit ankues parashtrimet e ISSH-së dhe DRSSH Tiranë sa i përket pretendimeve të ngritura në ankesë. Gjithashtu, Komisioneri kërkoi informacion nëse ankuesi i ka përfituar pagesat e pensionit të pleqërisë për muajt Janar dhe Shkurt 2025, gjatë periudhës së shqyrtimit të ankesës.

Fillimisht me e-mail-in datë 15.04.2025, ankuesi informoi Komisionerin duke sqaruar ndër të tjera se: “...Përsa i përket pezullimit të pensioneve, për shkak të ankesave të shumta të mijat, kudo... në mars u lejuan pagesat, dhe në muajin mars e prill i kam tërhequr normalisht, pa pengesë. Ndërkohë më janë dhënë edhe të prapambeturat. Theksoj se nga Komisioneri nuk kam kërkuar e nuk kërkoj të zgjidh çështjen e pensioneve apo të zbatimit të vendimit të gjykatës, por të konstatojë nëse ka patur apo jo diskriminim, me pezulimin e pensioneve, dhe marrjen e masave që ai parashikon. Unë nuk kam besim fare, se kjo gjë nuk do të ndodhë në të ardhmen, ndaj insisto vetëm te mbrojtja nga diskriminimi, konform ligjit...”.

Në vijim, përmes e-mail-it datë 16.04.2025, ankuesi depozitoi parashtrimet e tij, sa i përket përgjigjeve të ISSH-së dhe DRSSH-së Tiranë, duke theksuar ndër të tjera se: “...2. Nisur nga përgjigja, më duhet të theksoj edhe një herë para Jush, se me Ankesën drejtuar atij Institucioni, nuk kam kërkuar prej tij, që të më zgjidhë problemin e pensioneve (PKU, PPP e PSU) në kohën dhe masën e parashikuar nga ligji, pasi kjo nuk është në objektin e Tij, por bazuar në Ligj, fakte dhe prova, (faqe 10) i kam parashtruar ankimin për Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë nga DRSSH e ISSH, në fushën e sigurimeve shoqërore, si dhe marrjen e masave detyruese nga Komisioneri që të detyrojë këto Autoritete të ndërpresin veprimtarinë e tyre tendencioze diskriminuese, normalizimin e gjendjes dhe mospërsëritjen më në të ardhmen. Dhe po ashtu, përtej interesit tim, t’i detyrojë të marrin masa të shpejta dhe efektive për ndërgjegjësimin e punonjësve për respektimin e Kushtetutës, dhe ligjeve në fuqi, për sjellje e veprimeve korrekte për të zbatuar parimin kushtetues të barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimin. Kaq, asgjë më tepër...”

Ka patur dhe ende ka diskriminim, në të dy format, të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, gjatë trajtimit me PKU⁵, PPP⁶ dhe PSU⁷, që ka çuar në zvogëlimin drastik të pensionit, në moton “sa më pak pension ushtarakëve”, gjë e cila ka dëmtuar rëndë nivelin dhe cilësinë e jetesë sonë personale e familjare, si dhe ka shkaktuar dëm të pallogaritshëm moral: strese, vuajtje, shpërfillje, sorollatje në dyert e tyre dhe në ato të gjykatave, për të fituar të drejtën e bukës së gojës.

I theksoj Komisionerit se në ankim, (Rrethanat e çështjes), shkurt, kemi shënuar se për mosrespektim të kërkesave thelbësore të Kuadrit Ligjor për ushtarakët e FA, nga ana e DRSSH si për trajtimin me PKU, më tej atij të PPP e PSU, kanë cenuar të drejtën e pensionit duke mos e përfutur atë në kohën dhe masën e parashikuar nga ligji material, kam ushtruar ankime si ato administrativ në DRSSH dhe ISSH dhe më tej edhe gjyqësisht, me kërkesë padi, ku rezultoi:

a) Për pensionin e parakohshëm(PKU), të gjitha vendimet përfundimtare të Gjykatave, kanë pranuar pjesërisht kërkesë padinë, kanë qenë në favorin tonë, përkundër veprimeve të paligjshme të DRSSH. Për realizimin e plotë të objektit të padisë, kam vazhduar proceset gjyqësore, plot 12 vjeçar që paradoksisht s’ka përfunduar akoma dhe aktualisht është në Gj. Kushtetuese;

b) Për PPP dhe PSU, siç kam shpjeguar, me ankime për 2.5 vite rresht në DRSSH dhe ISSH, pas ballafaqimit, u zgjidh prej tyre problemi i masës, duke u vendosur në nivelin meritore ligjor (ai

⁵ - PKU – pension i parakohshëm për vjetërsi shërbimi i ushtarakut të FA

⁶ - PPP – Pension i plote i pleqërisë

⁷ - PSU – pension suplementar i ushtarakut, mbi atë të pleqërisë

max); Ndërsa për problemin e kohës (datës) së lindjes së të drejtës së këtij pensioni, për moszgjidhje i jam drejtuar gjykatës, e cila pas 8 vitesh e zgjidhi Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, përfundimisht në favorin tonë, me vendimin aktual nr. 1885, datë 11.11.2024.

c) Më hollësisht, trajtoj çështjen e paimagjinueshme, atë të pezullimit pa asnjë shkak ligjor, pa asnjë fakt, të pensioneve për muajin Janar dhe Shkurt, duke më lënë pa asnjë të ardhur financiare, si kulmin e shkeljes flagrante të ligjit nga DRSSH, dhe që përbën një diskriminim të pashembullt, që një gjë e tillë, mohimi i pensionit, bukës së gojës, nuk ndodh kurrë në asnjë vend të botës.

d) Në vijim, kam parashtruar, se veprimtaria e kundërligjshme e DRSSH, për trajtimin e PKU, PPP e PSU përfshin periudhën 1999-2025, ku jo vetëm shkelen të drejta themelore jetike, por arrihet deri në diskriminim të drejtpërdrejtë të ushtarakëve, në formë të fushës të ndryshme, trajtimin me dy e më shumë standarde për pabarazi e deri diskriminim, si dhe angazhimin tonë, në denoncimin e shkeljeve në format e mjetet e lejueshme ligjore, për vendosjen në vend të drejtave e interesave kushtetuese e ligjore të cenuara arbitrarisht prej këtyre autoriteteve shtetërore publike;

e) Në fund të ankesës shënohet masat që kërkoj të merren nga Komisioneri.

I theksoj Komisionerit, se edhe pse pensionist, në prag fund jete, referuar literaturës juridike, e reflektuar dhe në fushën që është objekt i atij Institucioni, qëllimi i Ankimit tonë, doemos është ai personal, kryesisht për të ndërhyrë që të konstatohet realisht e objektivisht diskriminimi, në kushtet e situatës aktuale, dhe në rast konstatimi të merren masat e duhura që gjykon Komisioneri, në funksion të detyrës kushtetuese, që jo vetëm të ndalohet, por edhe të mos përsëritet më në të ardhmen, si për mua a për këdo pensionist. Ndërkohë Qëllimi ynë, modest, synon edhe përtej interesit tim personal, në interes të shoqërisë, të konsolidimit të Shtetit të së Drejtës, të Shtetit Ligjor, të funksionimit si sahat të të gjitha institucioneve, duke zbatuar Kushtetutën dhe gjithë Kuadrin ligjor, për prosperitet të vendit. Nuk rrotullohet bota rreth meje, e as përmbysen ajo nëse m'u pezullua apo m'u ri dha e drejta e pagesës së pensionit por as nuk duhet të mbyllem sytë e veshët për situatën aktuale e sidomos për veprimtarinë shumë vjeçare të ISSH e organit vartës DRSSH në vite, lidhur me paligjshmërinë e veprimeve të tyre, që kanë çuar në diskriminimin e pensionistëve, në mënyra e formë të ndryshme, dhe të mos bëjmë sikur s'ka ndodhur e s'po ndodh asgjë, e ta mbyllem ankesën në arkiv se : "S'ka diskriminim!"

Parë në këtë kënd vështrimi, e ndjej të domosdoshme dhe të dobishme të bëj një plotësim të Ankimit, ku, duke dhënë prapësimet për "Kthim përgjigje", ndërkohë jap një panoramë të qartë, e të plotë, të situatës në vite, lidhur me veprimtarinë e ISSH e DRSSH për trajtimin me pension si ushtarak i FA, e në këtë kuadër, të të gjithë ushtarakëve, e më gjerë, të të gjithë pensionistëve.

FAZA I: Nga 01.01.1999 (me vendimin VCP nr. 1777, datë 17.02.2000) deri në 17.6.2011, për trajtimin me pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi të ushtarakut të FA të RSh.

Sikurse pohon DRSSH në paragrafin e dytë të "Kthim përgjigje", lidhur me vendimin për caktim pensioni nr. 1477, datë 17.02.2000, që ka caktuar masën e pensionit 8.000 lek/muaj me të drejtë fillimi më 01.01.1999: Edhe pse vetëdeklarohet nga DRSSH se është në zbatim të ligjit nr. 8087/1996 " Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të FA të RSH", në fakt, referuar Vendimit, shkruar e zeza mbi të bardhë, sikurse kemi parashtruar të gjitha gjykatat, përfshi edhe

Gjykatën Kushtetuese, rezulton se ky deklarin është disinformues, i pavërtetë dhe qëllim keq: Kjo për faktin se referuar përmbajtjes së tij (shikohet me sy të lirë), ka vetëm të saktë emrin, atësinë, mbiemrin dhe datëlindjen time, sipas dokumenteve, dhe nuk ka asnjë nga elementët e domosdoshëm dhe të detyrueshëm ligjore që dikton ligji 8087/96 dhe VKM në zbatim të tij, si dhe as të dhënat që ka dërguar organi kompetent, Ministria e Mbrojtjes me shkresën nr. 209, datë 12.01.2000. Ai është nxjerrë në bazë të ligjit tjetër nr. 7703/1993, “Për sigurimet shoqërore në RSH”, pa shënuar dispozitat e ligjit se ku bazohet, në përcaktimin e masës 8.000 lekë, pa fletë llogaritëse, për saktësinë dhe besueshmërinë ligjore, se pse del kaq dhe jo më pak 800 lek apo më shumë 8 milionë lekë.

(Për më shumë, trajtim shih “Gjykatës Kushtetuese: Prapësimet për komentet e DRSSH, me nr. 296/4, datë 05.12.2024,... që shoqëron ankimin tonë, drejtuar Komisionerit, faqe 1-5)

Pa u hyrë me imtësi të llogaritjeve të pensionit, në zbatim të ligjit që nuk është objekt i Komisionerit, theksojmë se në rastin konkret, diskriminimi shfaqet në këto aspekte:

a) DRSSH, i trajton pensionet e ushtarakëve në kundërshtim të hapur dhe flagrant me Kuadrin Ligjor të ushtarakëve e FA. Përtej kufijve të kompetencës që i njeh ligji, DRSSH, më trajton krejtësisht në mënyrë të paligjshme, duke zhveshur, zhgraduar nga OFICER aktiv i FA, që trajtohem me kuadrin ligjor specifik për Ushtarakët, më trajton si CIVIL madje të nivelit sakat, që trajtohen me ligjin tjetër nr. 7703/93 të sigurimeve shoqërore, ku pensioni fillestar, sipas ligjit datë 01.01.1999 (neni 11 i ligjit nr. 8087/96 i ndryshuar) nga 11,633 lek/muaj caktohet 8000 lek/muaj, 3.633 lekë më pak, çka cenon nivelin dhe cilësinë e jetesës si ushtarak.

b) Edhe pse paligjshmërisht cakton pensionin maksimal si civil në shkallë vendi, dhe jo atë meritor si ushtarak, DRSSH bën diskriminimin tjetër; Krejt në kundërshtim me Kuadrin ligjor të ushtarakëve, që e parashikon përmirësimin dinamik të tij, krahas ushtarakëve aktivë të FA, e lë këtë pension në frigorifer, “të ngrirë”, pa asnjë ndryshim, çka krijon dallim, diferencim dhe zvogëlim të paligjshëm të masës së pensionit, që prek nivelin e jetesës, ndërkohë që ligji i zbatueshëm, sanksionon ndryshimin pozitivisht, krahas zhvillimit e përparimit të dinamikës së pagesës së ushtarakëve aktivë, ndryshim që u përket si përfitim edhe për ushtarakët në lirim e në pension.

c) Për moszbatim ligji dhe cenim të së drejtës së ushtarakëve, prej DRSSH, dhe jo kundër komandave apo ministrisë për Pagesën Kalimtare, qysh nga viti 2004 e deri sot, rreth mbi 5 mijë ushtarakë “sulmuan dhe pushtuan” dyert e gjykatave: Dhe falë integritetit moral dhe profesional të lartë të shumë gjyqtarëve, që përballuan presionet e jashtme e të brendshme të të gjitha pushteteve, fituan pjesërisht apo tërësisht të drejtën e vet ushtarakët, dhanë vendimet e tyre kundër DRSSH, duke e detyruar t’u kthejë diferencat e pensioneve të mbajtura si rezultat i keqzbatimit të ligjit. Pra këta ushtarakë, fituan pensionin sipas ligjit, ndërsa ne të tjerët, që bëmë ankesa më vonë, mbetëm në nivelin që na cakton paligjshmërisht DRSSH. Konkretisht, ndërsa pensioni, sipas ligjit, që përfituan mbi 5 mijë ushtarakë, në 01.05.2009 arrin në nivelin 45.180 lekë/muaj, pensioni ynë, i pasqyruar në VCP 1477/2000, i paguar është 16.926 lekë, ose 3.3 herë më pak. Pra kemi diferencim me pasoja juridike negative, trajtim të padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm midis të barabartëve (ushtarake në të njëjtat kushte ligjore objektive).

d) Kemi diskriminim më tej, në aspektin tjetër: DRSSH pretendon paligjshmërisht dhe vendos arbitrarisht që pensioni i parakohshëm të mos kalojë pensionin maksimal të pleqërisë në shkallë vendi, pra, në kundërshtim me nenin 11 të ligjit nr. 8087/96 të ndryshuar, jo sa e tëra, dhe as 50% për 15 vjet vjetërsi shërbimi, e katandis atë sa shtesa për 7 vjet mbi 15 vjetshin (shih neni 11 të ligjit). Mandej edhe rritjen e tij në vite (indeksim) e bën mbi bazën e VKM për pensionet suplementare të ushtarakëve, që janë sa $\frac{1}{2}$ e pensioneve të pleqërisë. Kjo është një shkelje flagrante dhe diskriminim pasi me këtë mënyrë trajtimi, pensioni, i quajtur maksimal fillimisht, rrënohet e zvogëlohet vazhdimisht dhe ndodhi që realisht, më 01.05.2009, ndërsa sipas VKM nr. 415/2009 pension maksimal i pleqërisë është 20.552, pagesa nga DRSSH, sipas VCP 1477/2000 është në vlerën 16.926 lekë, ose 20% me pak. Pra kemi dallim, trajtim të pafavorshëm, të padrejtë e të pabarabartë midis të barabartëve, madje na kthen nga oficer në civil, na dallon e diferencon edhe nga civilët, duke na paguar më pak (Për më tepër, Shih faqen 6 të Prapësimeve, drejtuar Gj. Kushtetuese).

e) Por diskriminimi vazhdon akoma në vijim, me qëndrimin paradoksal të DRSSH, që edhe pse ligji në mënyrë specifike parashikon indeksimin çdo vit të pensioneve, (neni 18 i ligjit nr. 8087/96 i ndryshuar, apo VKM nr. 63/2006, në aspektin e kompensimit të inflacionit, pra rritjes së çmimeve të shportës, kryesisht të energjisë elektrike dhe të bukës, sipas VKM përkatës nr. 138/1994 (350 lek/muaj) dhe nr. 471/1996, 150 lek/muaj), nuk respektohet nga DRSSH me justifikim absurd se ju ushtarakët nuk jeni subjekt i ligjit nr. 7703/93. Për rrjedhojë, kemi trajtim të paligjshëm, të padrejtë e të pabarabartë që do të thotë se kemi diskriminim pasi edhe ne ushtarakët jemi qytetarë të këtij vendi, dhe harxhojmë energji, hamë bukë, blejmë ilaç e shërbime të tjera, që ligji, na i garanton, por DRSSH na i mohon. Pra kemi trajtim të pabarabartë, midis të barabartëve, në kushtet të njëjta, lidhur me përbërësin e inflacionit, çka përbën diskriminim.

Faza II: Nga 17.06.2011 deri 04 dhjetor 2024, për trajtimin me pension të plotë pleqërie e suplementar të ushtarakut të FA të RSH, Vendimet nr. 3822/2011 dhe nr. 187/2011.

Sikurse deklarohet nga DRSSH në paragrafin e tretë të “Kthim Përgjigje” se me Vendimin nr. 3822, datë 25.07.2011, ka caktuar pension të plotë pleqërie me 40 vite e 5 muaj, me të drejtë pagese nga data 17.6.2011, me masë fillestare 12.191 lek/muaj, dhe në vijim në gjithë paragrafët e faqes 1 deri 3 përfshi, në mënyrë të sforcuar informon Komisionerin me kronologjinë e këtij pensioni, duke shënuar shpesh rillogaritje, rishqyrtim etj. e plot shifra, data, numra ligjesh e numra vlerash pensioni në vite, që sipas saj janë në zbatim të neneve 31, 32, 92 të ligjit nr. 7703/93 të ndryshuar “Për sigurimet shoqërore në RSH”, por që askush nuk i merr vesh nëse këto shifra, dispozita të ligjeve, janë realisht të zbatuara me korrektësi, sikurse parashikon ligji. Ndërkohë kemi vetëm deklarime dhe nuk thotë asnjë fjalë, për pretendimet tona, dhe nuk jep asnjë argument, asnjë provë, asnjë dokument nëse këto ligje janë zbatuar realisht me korrektësi. Ajo nuk thotë asnjë fjalë nëse këto llogaritje e shqyrtime, për paligjshmëri e pasaktësi, janë ankuar në gjykata, nuk thotë se ç’kanë vendosur gjykatat etj. Ajo nuk thotë asgjë nëse nga ana e saj nuk ka pasur trajtim të padrejtë, të pafavorshëm, e të pabarabartë, që të çojnë në diskriminim, përkundër pretendimeve tona.

Nga që kam ndjekur nga afër tërë kronologjinë e veprimeve e mosveprimeve të DRSSH edhe për këto pensione, i theksoj Komisionerit, se edhe për këtë fazë, DRSSH parqet një situatë krejtësisht të gënjeshtër, disinformon, në mënyrë të sforcuar, fsheh të vërtetën e veprimeve e mosveprimeve të saj në kundërshtim të hapur e flagrant me të gjithë kuadrin ligjor procedural dhe material edhe për trajtimin e këtyre pensioneve, ka abuzuar me detyrën funksionale, ka zvogëluar në mënyrë drastike masën e pensioneve që takojnë sipas ligjit, duke bërë një trajtim me disa standarde, me dallime, diferencime e deri në diskriminim. Pikërisht për paligjshmërinë e veprimeve të saj, jemi ankuar si administrativisht e gjyqësisht dhe rezulton e kundërta e vetëdeklarimeve të saj, që janë lehtësisht të verifikueshme, pasqyruar në vetë aktet e saj administrative të dala nga koha në kohë, dhe po ashtu në vendimet e shumta të gjykatave të sistemit të zakonshëm, përfshi dhe Gjykatën e Lartë, dhe madje, sikurse shprehemi edhe ne ankim, për vazhdimësinë e këtyre shkeljeve, e mosriparimin e tyre, kemi bërë edhe kallëzim penal për Drejtorin e ISSH.

Le të përmendim shkurt, shkeljet dhe në përfundim të parashtrojmë se ku janë shfaqur realisht diskriminimi, i drejtpërdrejtë apo i tërthortë në trajtimin e këtyre pensioneve:

- a) Shkelja e parë e ligjit lidhet me masën e pensionit: Sikurse shihet, masa e tij është caktuar në vlerën 12.191 lekë/në muaj, por nuk ka asnjë fletë llogaritje pse del kaq dhe jo më shumë, dhe pse kjo masë, përkundër dispozitave të ligjit dhe të dhënave personale të dërguara nga Ministria e Mbrojtjes, del paksa më tepër se pensioni minimal në shkallë vendi, kur sipas ligjit, duke qenë ushtarak, me gradë, funksione e pagë të lartë, më takonte pensioni maksimal, që në atë periudhë, sipas VKM nr. 474, dt. 30.6.2010, është në vlerën 21.380 lekë/muaj. Pikërisht të gjitha llogaritjet në vijim deri në datën 10.10.2013, janë bërë në mënyrë shkel e shko, në kundërshtim me ligjin, dhe se ato janë bërë jo për rishqyrtim apo ndonjë shkak tjetër, por për ankesat e vazhdueshme tonat, për 2.5 vjet që mbeta në dyert e DRSSH dhe ISSH, dhe u vendos në nivelin meritior vetëm pas letrës që i drejtoj Drejtoreshës së ISSH, ku e vura në dijeni se për shkeljet e ligjit do të bëj kallëzim penal për gjithë punonjësit që janë marrë me këtë llogaritje. Drejtoresha urdhëroi ballafaqim me Drejtorin e Auditit në ISSH, ku përballë ligjit, faktit dhe provave, “U dorëzua” dhe pranoi se pensioni është llogaritur gabim dhe se më takonte pensioni maksimal, kohës, sipas VKM përkatës (21.380) me të drejtë përfitimi nga data 17.06.2011. Ky fakt provohet nga vendimet D, datë 10.10.2013 për pensionin e pleqërisë dhe vendimi D, datë 11.10.2013 për pensionin suplementar, si dhe në “Kthim Përgjigje”, nr. 8429/1 prot., datë 22.10.2013, të Drejtoreshës së ISSH, znj. Vjollca Ibro, në të cilën shkruhet: ... Nga auditimi i dokumenteve në dosjen nr. 196553/1 (pensioni i pleqërisë ...ii) dhe me dosjen nr. 4045, suplementari i pleqërisë, ankesat tuaja janë të drejta. Për pensionin e pleqërisë ju dërgua DRSSH Tiranë për rishqyrtim dhe u përfundua duke shkuar pagesa në arkën postare nr. 24, pasi llogaritja e bërë ju përfitoni pensionin maksimal nga data 17.6.2011 dhe sot në masën 24.050 lekë, si dhe të gjitha diferencat ju takojnë nga data e lindjes së të drejtës (17.6.2011) në shumën 25.607 lekë. Për pensionin suplementar ju dërgua DRSSH për rishqyrtim dhe u përfundua duke shkuar pagesa në arkën postare nr. 24 dhe të gjitha diferencat ju takojnë nga data e*

lindjes së të drejtës (17.6.2011) për shumën 23.960.” (Shih letrën dhe përgjigjen, e Drejtoreshës së ISSH, V. I., të administruara si dokument shoqërues Ankimit tonë aty).

Theksoj Komisionerit, se deri në 10 nëntor 2013, nga DRSSH janë bërë 7 rillogaritje pensioni, nga të cilat 5 janë reflektuar në dosje, për shkak të ankesave tona, dhe jo për ndonjë shkak tjetër, siç vetëdeklaroi me pavërtetësi DRSSH. Gjithashtu i theksoj se me këtë masë pensioni, që u vendos në vendin meritigjor (pra maksimumi për të dy pensionet) jam paguar qysh nga nëntori 2013 deri në dhjetor 2024 (përfshi), natyrisht duke iu shtuar atij indeksimet në vite, si për të gjithë pensionistët. Rrjedhimisht, e tërë historia kronologjike e llogaritjes së këtyre pensioneve që paraqet DRSSH, me plot shifra, është fare, fare E PAVËRTETË, është ZERO, pa asnjë vlerë, e provuar nga vendimet e cituara dhe Përgjigja e Drejtoreshës së ISSH, Vjollca Ibro.

Përsa më sipër natyrshëm lindin pyetjet:

- Përse duhet të ankohet pensionisti për moszbatim korrekt të ligjit dhe keq llogaritje, ku ky organ shtetëror është i specializuar pikërisht në këtë fushë, për zbatimin me përpikëri e unik të ligjit për të gjithë qytetarët?

- Pse duhet të rillogaritet 7 herë pensioni, në 2.5 vite sorollatje dhe që të gjitha llogaritjet më nxjerrin kreditor me të drejtë, datën e fillimit 17.6.2011, dhe jo një herë, apo maksimal, si gabim njerëzor, deri dy herë?

- Përse duhet t'i drejtohem me ankesë Drejtoreshës së ISSH, ku DRSSH është organ kompetent për zbatimin e ligjit, edhe në fushën e pensioneve?

Pyetja tjetër është: Ku është shfaqur konkretisht ky diskriminimi, në fushën e sigurimeve shoqërore?

i. DRSSH, nuk respekton fare-fare kuadrin ligjor për ushtarakët, (si shtet mbi shtetin) edhe në këtë rast, ajo ka vendosur arbitrarisht caktim pensioni gati si civil të rëndomtë, pra nga oficer i lartë karriere, në civil, si karrocier sakat, në vlerën paksa pensioni minimal, në masën 12.191 lekë, dhe jo atë maksimal, (21.380 lek/muaj) që rezultoi sipas ligjit, duke dëmtuar kështu nivelin dhe cilësinë e jetës së ushtarakut në pension. Rrjedhimisht kemi diferencim e pabarazi, midis të pabarabartëve, ku trajtohem si civil dhe jo si ushtarak.

ii. Ndërkohë, që po ky pension, në masën e parashikuar nga ligji, u është caktuar maksimal 21.380 dhe e kanë përfituar të gjithë kolegët e tjerë (të njohur nga afër), në kushte objektivisht të njëjta, ndërsa për mua JO, por ai caktohet 12.191 lek/muaj, paksa mbi minimumin. Pra kemi diferencim, padrejtësi e pabarazi midis të barabartëve(ushtarakeve).

b) Shkelja e dytë lidhet me datën e përfundimit të pensionit të parakohshëm dhe lindjen e të drejtës së përfitimit të pensionit të plotë të pleqërisë dhe pensionit suplementar të ushtarakut mbi atë të pleqërisë, që sipas ligjit është data 17.06.2009 dhe JO data 17.06.2011 që cakton DRSSH.

Sikurse pohohet nga vetë DRSSH, sipas vlerësimit të saj, më datën 16.06.2011 përfundon trajtimi i pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi (Vendimi 1477/2000) dhe më 17.06.2011 më lind e drejta e përfitimit të pensionit të plotë të pleqërisë (Vendimi 3822/2011) dhe ai suplementar (nr. 187/2011).

Referuar nenit 11 dhe 12 të ligjit material nr. 8087/96 i ndryshuar, “Për sigurimet shoqërore suplementare të ushtarakëve të FA të RSh”, si dhe neneve 31, pika 1 dhe 92 të ligjit nr. 7703/’93 i

ndryshuar “Për Sigurimet Shoqërore në RSh”, si dhe kushteve e kriterëve të këtyre ligjeve, kryesisht tabelës së nenit 92, si dhe në zbatim të VKM nr. 526, datë 20.12.1958 “Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni”, i ndryshuar, ku punët/profesionet që kam kryer Mësues dhe Ushtarak aktiv i FA (Oficer), që përfshihen në listën nr. 2 të vendimit, për punë/profesione të kategorisë II (kreu XXII dhe XXVI), duke qenë i datëlindjes 17.12.1946, e drejta e përfitimit të pensionit të plotë të pleqërisë më lind më 17.06.2009 dhe JO 2 vjet më vonë, më 17.06.2011, që vetpërcakton në kundërshtim me ligji DRSSH. Kjo shtyrje afati 2 vjet, më ka cenuar rëndë të drejtën e përfitimit të pensioneve në fjalë, pasi 2 vjet jam paguar përkatësish 16.926 lekë (për një vit) dhe 17.603 (për një vit), ndërkohë që sipas ligjit më takonte në masën 30.826 lekë (20.552 i pleqërisë + 10276 suplementari) pra diferenca 13.900 lekë/muaj për vitin 17.6.2009-17.6.2010 dhe në masën 14.558 lekë/muaj, që për gjithë periudhën 2 vjeçare arrin në vlerën e një dëmi ekonomik 340.056 lekë, (pa 12.000 lekë kompensimet energji + bukë), pa llogaritur këtu dëmin moral.

DRSSH, nisur nga motive të dobëta, e pse jo politike, “sa më pak pension ushtarakëve”, duke qenë se masa e pensioni të parakohshëm që merrja ishte më e vogël se masa e pensionit të pleqërisë + suplementar, e la në heshtje çështjen, dhe vetëm me interesimin tim e shtyri vetëm 2 vjet, se mund të vazhdonte edhe më tej. Në ankimin tonë, DRSSH, nxori argumentin absurd se nuk plotëson kushtet e kategorisë II, por asaj III, një arsyetim ky jo vetëm i pabazuar në ligj, por edhe alogjik, pasi unë si ushtarak, për punën e kryer përfshihem në kushtet e Kategorisë II (Vendimi 526/1958 i cituar), dhe JO i kategorisë III, në të cilën përfshihen vetëm punonjësit CIVILË, punë të zakonshme dhe JO ushtarakët.

Duke mos gjetur zgjidhje nga ana e DRSSH dhe ISSH, iu drejtova Gjykatës.

Sikurse shprehet në mënyrë selektive dhe jo realisht DRSSH (paragrafi i fundit, faqe 3) Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me Vendim nr. 762, datë 28.02.2017, vendosi “Rrëzimin e kërkesë padisë” (Gjykata pa iu referuar ligjit, fakteve e provave, u nis me arsyetimin absurd e të anshëm se kishte kaluar më shumë se një vit nga lindja e të drejtës që kam bërë kërkesë për dalje në pension). Më më tej DRSSH, jo pa qëllim hesht, nuk e vazhdon historikun kronologjik të shqyrtimeve në gjykata, se çfarë vendosën ato, pikërisht për këtë çështje.

Kundër vendimit u ankova në Apel, e cila me vendimin nr. 920, dt. 27.3.2019 vendosi: Prishjen e vendimit nr. 762/2017 të Gj. Adm. Shkallës Parë Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim me tjetër trup gjykues”. DRSSH u alarmua me vlerësimin dhe vendimin e Gjykatës dhe nxitoi të bëjë Rekurs në Gjykatën e Lartë, (e cila vitet e fundit, palë me Qeverinë, dukshëm e ka mbështetur atë padrejtësisht) ku shtroi po këto pretendime dhe kërkoi rrëzimin e padisë. Ndërsa nga ana jonë u bë kundër rekurs.

Kolegji i Gj. Lartë, pas 3 vjet e 6 muaj, me vendim nr. 424, dt. 12.12.2022 vendosi “Prishjen e vendimit nr. 920/2019 të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues” orienton se në fokusin e saj të përcaktojë datën e saktë të lindjes së të drejtës së përfitimit të PPP e PSU.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendim nr. 1885, datë 11.11.2024, vendosi, sikurse vetdeklaroi dhe shënohet nga vetë DRSSH, në krye të faqes 4, ku ndryshon jo vetëm vendimin nr. 762/2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së parë (Pika 1 e vendimit), por edhe vendimin nr.

3882, datë 25.25.7.2011 dhe vendimin nr. 187, datë 15.12.2011 të DRSSH, lidhur me datën e fillimit të së drejtës për pension pleqërie dhe suplementar nga data 16.6.2011 në datën 17.6.2009, (pika 3 e vendimit) si dhe detyrimin e DRSSH të më paguaj diferencat e pensionit të pleqërisë dhe atij suplementar të indeksuar sipas viteve për periudhën 17.6.2009-17.6.2011 (pika 4 e vendimit). Në pikën 6: Ky vendim përbën titull ekzekutiv dhe është i ekzekutueshëm nga përmbartimi gjyqësor.

Sikurse pohon, vendimi i më sipër i arsyetuar, është bërë e ditur nga Gjykata më datën 4.12.2024. Pra, pas 8 vitesh, proces gjyqësor, me këtë vendim rrëzohen të gjitha pretendimet e DRSSH, lidhur me kohën e lindjes së të drejtës së pensionit të pleqërisë dhe atij suplementar, dhe çdo pretendim të njëjtë që tani përsëritet para Komisionerit, është tërësisht i pabazuar në ligj, dhe kjo është certifikuar edhe nga vendimi i Gjykatës së Apelit, i cili është përfundimtar i formës së prerë.

Prapësimet tona për veprimet diskriminuese edhe për këtë fazë, paraqiten si vijon:

Sikurse kemi referuar edhe para të gjitha gjykatave, me fakte e dokumente, DRSSH duke shkelur haptazi dispozitat e ligjit procedural e atij material, me shtyrjen 2 vjet të daljes në pension, më ka diferencuar, dalluar e trajtuar në mënyrë të pabarabartë, e të pafavorshme me kolegët, në kushte objektivisht të njëjta, duke vepruar me tre standarde, konkretisht:

Është kreu e kundërligjshme, e pafalshme e patolerueshme, abuzive, e pandershme dhe mjaft e dëmshme, situata reale që në të njëjtat kushte objektive, në të njëjtat bazë ligjore, me të njëjtën palë, në të njëjtën vitlindjeje (1946), në të njëjtën kategori shërbimi, në kushtet e punëve të kategorisë II, (oficerë), me të njëjtat vite shërbimi, kolegët P. A. dhe B. Q., janë trajtuar në pajtim me ligjin neni 92 (tabela) kur plotësojnë moshën sipas tabelës, 62 vjeç, ndërsa unë, jo!

Paligjshmërisht, nxirrem në pension pleqërie me 2 vjet vonesë (64 vjeç e 6 muaj), tejzgjatur paligjshmërisht periudha e trajtimit me pension të parakohshëm, duke më paguar kështu sa gjysma e pensionit që më takon prej pensionit pleqërisë dhe suplementar të ushtarakut (14.000 lek/muaj më pak, për dy vjet);

Po ashtu edhe kolegu L. Z., nxirret në pension pleqërie 4 vjet me vonesë;

Më absurd është fakti, unë trajtohem gati njëlloj e në të njëjtën kohë me kolegun P. T., i datëlindjes 1948, i cili është 2 vjet më i vogël në moshë, (shih provat, në rastet analoge)

Konkretisht, për secilin ditëlindja, librezë, koha e daljes në pension është si më poshtë:

- P. A., datëlindja 1.3.1946, Libreza nr. 173602/1, me fillim 1.3.2008; (del 62 vjeç);
- B. Q., datëlindja 3.2.1946, Libreza nr. 2442, me fillim 3.2.2008 (del 62 vjeç);
- I. I. datëlindja 17.12.1946, Libreza 196533, më 17.6.2011 (del 64 vjeç e 6 muaj);
- L. Z., datëlindja 6.2.1946, Libreza nr 20561, me fillimi 01.12.2012.(del jo 62 vjeç, as 64 e 6 muaj, as 65, por 66 vjeç);
- P. T., datëlindja 29.2.1948, Libreza nr. 200340/1, me fillim 1.3.2012, 64 vjeç, absurdi që është 2 vjet më i vogël, ai del në pension 64 vjeç, unë 64 vjeç e 6 muaj.

Pra kemi diferencim dallim padrejtësi, pabarazi e paligjshmëri brenda të barabartëve.

ii) Më paradoksalja qëndron në faktin, se DRSSH, edhe në këtë rast, në mënyrë arbitrare, tej kompetencës që i njej ligji, nga ligjzbatuese na bëhet ligjvënëse (përsëri shtet mbi shtetin), shpërfill

dispozitat e Ligjit nr. 7703/93 dhe përcaktimet e VKM nr. 526/1958, duke shkelur parimin themelor, atë të ligjshmërisë, më zhvesh, zhgradon dhe më kthen nga Oficer, në kushtet e kategorisë II (vendimi 526/1958), në kushtet e Kategorisë III, ku përfshihen vetëm civilët dhe jo oficerët. Në kategorinë III përfshihen punë/profesione që nuk përfshihen në VKM nr. 526/1998, që janë të Kategorisë I (punë shumë të vështira) dhe të Kategorisë II (punë të vështira), (ku I dhe II janë punë me rrezikshmëri jete, e jetëgjatësi të shkurtër). Në kategorinë III janë punë/profesione të tilla CIVILE, të zakonshme, që sipas manualit të ISSH përfshin: punonjësit e administratës civile, ekonomistët, juristët, financierët, përkthyesit, kompjuteristët, menaxherët, magazinierët, shoferët, punonjësit e mirëmbajtjes, të tregtisë, të biznesit, të bujqësisë, të blegtorisë etj, në të cilat nuk kam punuar kurrë asnjë ditë.

iii) Kjo shpërfillje, deformim e keqzbatim i ligjit, passjell pasojën juridike të pengimit të gëzimit të drejtës së ushtarakëve për të përfutur pensionin përkatës në kohën dhe masën e parashikuar nga ligji, e cila është më e madhe (gati 2 fishi) se ajo e pensionit të parakohshëm që paguante DRSSH.

Në këtë rast, veç diferencimit e trajtimit të padrejtë, të pabarabartë, të pafavorshëm të mësipërm, kemi trajtim të padrejtë e të paligjshëm, pasi më pengon dhunshëm mundësinë për të përfutur e gëzuar pensionin që më garanton ligji, kjo përbën diskriminim të drejtpërdrejtë.

FAZA III: Nga 4 dhjetor 2024 deri sot prill 2025, që lidhet me zbatimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, nr. 1885, dt. 11.11.2024 dhe sidomos me veprimin ekstrem të DRSSH, për pezullimin e pagesës së pensionit të pleqërisë dhe atij suplementar të ushtarakut, për muajt Janar dhe Shkurt 2025.

Referuar “Kthim përgjigje”, në veprimtarinë e DRSSH evidentohen dy probleme:

Problemi i parë: Zbatimi i detyrueshëm i Vendimit të Gjykatës Administrative nr. 1885, datë 11.11.2024, si titull ekzekutiv, që detyron DRSSH të llogarisë pensionin e pleqërisë dhe atë suplementar, me datë fillimi 17.6.2009, si dhe kthimin e diferencave të papaguara që rezultojnë nga keqzbatimi i ligjit për periudhën 17.6.2009 – 17.6.2011.

Problemi i dytë: Pezullimi i pagesës së pensionit të pleqërisë dhe atij suplementar periodik mujor, për muajt Janar dhe Shkurt 2025, pensione tashmë të llogaritur po prej saj, në pajtim me ligjin, dhe paguar rregullisht nga 10 nëntor 2013 deri dhjetor 2024 (përfshi).

Lidhur me problemin e parë:

1. Qysh në krye theksojmë Komisionerit, se zbatimi i Vendimit të Gjykatës, është çështje krejtësisht tjetër, dhe nuk ka lidhje fare-fare me objektin e ankesës sonë drejtuar Komisionerit, për pretendimet për diskriminim, dhe si i tillë, argumentet e Saj nuk vlejnë fare për Ankimin në fjalë.

2. Ajo që bie dukshëm në sy, është se DRSSH dhe ISSH, janë alarmuar me Vendimin e Gj. Apelit, dhe kërkojnë të gjejnë sadopak justifikime për të intimiduar Gjykatën, për ndryshimin e vendimit të saj, me anën e “Kërkesës për Sqarim e Interpretim vendimi”, që ta zvarrisin zbatimin pambarimisht, ku dihet fare mirë se çështja e zbatimit nuk ka aspak vështirësi për llogaritje

pensionit për periudhën e në fjalë, por vështirësia qëndron vetëm në mungesën e vullnetit dhe të dëshirës së DRSSH, për të respektuar Ligjin dhe për të zbatuar vendimin detyrues të Gjykatës së Apelit, i formës së prerë. Po ashtu synon të intimidojë edhe Përmbaruesit për ekzekutimin e Vendimit.

3. Gjithë veprimet që përshkruhen, janë praktika të brendshme midis DRSSH dhe organit epror ISSH, dhe nuk kanë të bëjnë fare me dhënien e përgjigjeve që kërkon Komisioneri, lidhur me pretendimet tona në ankim. Nëse zbatohet ose jo Vendimi i Gj. Apelit, nuk është detyrë e Komisionerit të zgjidhë çështjen. Dhe ne nuk i kemi kërkuar një gjë të tillë. Ka rrugë e mjete ligjore për të zgjidhur çështjen edhe për zbatim të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

4. Ajo që bie në sy dukshëm është përpjekja e sforcuar e DRSSH dhe organit Epror, për të moszbatuar vendimin e Gjykatës, për ta zvarritur atë pambarimisht në kohë. Kjo edhe për faktin e dukshëm se kanë kaluar mbi 4 muaj dhe ende nuk është zbatuar, nuk bëhen 4 veprime të thjeshta aritmetikore, për të llogaritur pensionin si dhe përcaktuar diferencat e papaguara, që përbën një shkelje flagrante madje përbën precedent të rrezikshëm për këtë autoritet shtetëror, lidhur me mosrespektimin ligji dhe dhunimin e të drejtave dhe interesave kushtetuese e ligjore të qytetarëve pensionistë dhe arrin deri në refuzim të zbatimit të vendimit të gjykatës, me pretekste vështirësie.

5. Kjo zvarritje, pa kurrfarë arsye e shkak ligjor, ka passjellë pasoja negative, dëm ekonomiko-financiar dhe moral, e deri shpërfillje e diskriminim, ka ulur ndjeshëm në nivelin e cilësinë e jetës, ka dëmtuar dinjitetin dhe personalitetin tonë, ka krijuar shqetësime, strese, frikë e pasiguri, mosbesim të skajshëm që shkon deri në urrejtje, pasi DRSSH na paragjykon e trajton si kundërshtar apo si armik, dhe jo si qytetar i ndershëm, bashkëpunëtor për respektimin reciprok e sigurimin e një bashkëpunimi normal, për mirëadministrim të veprimtarisë administrative të këtij autoriteti, në shërbim efektiv e jo burokratik ndaj qytetarëve.

6. Në Kthim përgjigje, ndër të tjera, shënohet se me vendim X apo Y është llogarit Z apo Zh pension. Si më i interesuar, krejt ndryshe nga sa parashikojnë ligjet, nuk më është dhënë asnjë nga këto vendime, nuk jam njoftuar për asgjë, se si e qysh janë bërë këto llogaritje, mbi ç'bazë ligjore, cilat janë të dhënat faktike që e bëjnë ato të besueshme, të sakta e të vërteta. Pra, ka një mungesë totale transparence, ndaj kemi arsye të shprehemi se ngaqë s'ka transparencë ekziston fshehja e të vërtetës, kjo për faktin se nuk ka fare bashkëpunim, edhe pse u kam dhënë të dhëna të plota për rillogaritjen e shpejtë dhe të saktë, nëpërmjet përfaqësueses juridike Migena Tota.

Lidhur me problemin e dytë: i cili përbën thelbin e ankimit tonë pranë Komisionerit për diskriminim, si kulmin e kësaj veprimtarie diskriminuese të DRSSH në vite, është veprimi ekstrem krejtësisht i paligjshëm, e deri kriminal, ai i ndalimit të pagesës së pensionit për muajt Janar dhe Shkurt 20025, bukës së gojës, si i vetmi burim ekonomiko-financiar periodik mujor, pa asnjë të ardhur tjetër.

Në fund të faqes 5 dhe 6, të “Kthim përgjigjes” shënimet: Lidhur me pyetjen Tuaj, se cilat janë arsyet e ndalesës së pagesë për muajt janar dhe Shkurt 2015, nëse janë evidentuar nga ana jonë problematika, si në rastin e I. I., ju bëjmë me dije se:...

1. Argumenti që sjell, është jashtë logjikës juridike, madje jashtë logjikës së shëndoshë njerëzore, që nuk justifikon fare veprimin ekstrem të ndalimit të pensionit mujor, bukës së gojës.

2. Argumenti që sjell është përpjekje e sforcuar e DRSSH, në kundërshtim të hapur me Kushtetutën, Konventë, Legjislacionin në fuqi e kryesisht me Kodin e Pr. Administrative, madje dhe me Rregulloren nr. 1/2008, të ISSH,...

... a) DRSSH, edhe pse përmend vendimin nr. 3882/4, dt. 10.12.2024, si akt administrativ, ajo me gjithë kërkesat e ankesat tona të vazhdueshme nëpërmjet emaileve të administruara, apo duke mbetur në dyert e zyrave të tyre, nuk ka dhënë fare ndonjë akt administrativ të tillë, dhe nuk i jep asnjë dokument edhe Komisionerit që të provojë se ky vendim, akt administrativ që shpreh vullnetin e këtij autoriteti, ekziston, se ai është i bazuar në atë apo këtë në ligj, në filan dispozite dhe të na njohë me arsyetimin dhe dispozitivin e tij, se cilat janë shkaqet ligjore që e kanë detyruar atë të ndalojë (pezullojë) pagimin e pensioneve për muajt Janar dhe Shkurt 2025;

b) Sipas pikës 1, nëse ekziston ky akt administrativ i DRSSH, ai i fillon pasojat juridike, që prekin të drejta e interesat tona vetëm me njoftimin e këtij akti, (që në rastin konkret shuan marrëdhënien juridik, lidhur me pagesën e pensionit për muajt Janar dhe Shkurt 2025 e vijim, (pasi nuk dihej, vazhdohej edhe më tej, nëse nuk do të ankohesha në të gjitha instancat deri te Kryeministri(s' di a e ka marre emailin); ... Pika 3 e saktëson edhe më mirë detyrimin për DRSSH, se pasojat juridike nuk fillojnë në asnjë rast përpara njoftimit të personit që i drejtohet akti, sipas pikës 1 të këtij neni.

c) Por nga ana e DRSSH, me gjithë kërkesat e ankesat tona, nuk kam marrë asnjë njoftim, asnjë akt, asnjë vendim, asnjë urdhër, që do të ndalohej (pezullohej) pensioni i pleqërisë dhe ai suplementar për muajt Janar e po ashtu për muajt Shkurt 2025. Përkundrazi, ky akt edhe nëse ekziston, mbahej i fshehtë, nuk më jepej as njoftimi, as vendimi i arsyetuar dhe as përgjigje për shkakun ligjor të këtij pezullimi të pensioneve, sipas ankesave me emaile, apo me çdo formë tjetër.

Referuar korrespondencës sonë me ISSH e DRSSH, si dhe "Kthim përgjigje", rezulton se:

a) DRSSH, nuk jep se cilat janë faktet e provuara prej saj që vënë në dyshim apo vërtetojnë cenimin e legjitimitetit të pensioneve (që unë të kem gënjyer, mashtruar apo falsifikuar të dhëna, dokumente etj. mbi bazën e të cilave është llogaritur e vendosur pensioni, në kundërshtim me ligjin)

b) DRSSH nuk më jep asnjë informacion, asnjë shkak ligjor, a fakt të besueshëm që të kenë sinjalizuar DRSSH apo ISSH, apo të ketë kryer kontroll dhe se ka gjetur fakte që cenojnë legjitimitetin e pensionit, e për rrjedhojë mbi bazën e tyre ka marrë vendimin për pezullim të tij;

c) DRSSH, nuk jep asnjë vendim a urdhër, që mbi bazën e fakteve të konstatuara e provuara mbi bazën e të cilave fakte e baze ligjore vendimi apo urdhëri i pezullimit të pensionit;

d) DRSSH, në fillim Janari 2025 më ka hequr nga listëpagesat e dërguara në Agjencinë Postare A-24, por nuk jep asnjë akt se mbi cilat fakte, prova dhe mbi cilën bazë ligjore ka vendosur heqjen nga lista dhe pezullimin e pensione për muajt e cilësuar;

e) DRSSH nuk ka bërë asnjë njoftim zyrtar personalisht apo të thërrasë në zyrë e të më komunikojë vendimin e pezullimit dhe vënien dijeni mbi shkaqet e pezullimi, të mbahet proces verbal, të më komunikohet pasojat juridike, të më shpjegohen të drejtat dhe detyrimet për

plotësimin e dokumenteve të nevojshme për rifitim të drejtës së pagimit të pensionit, si dhe të drejtën e ankimit, etj. këshillime këto konform ligjeve dhe sidomos të Kodit Pr. Administrative;

f) Me gjithë kërkesat tona për bashkëpunim që i kam paraqitur juristes përfaqësuese M. T., nuk mu afrua kurrë bashkëpunimi për llogaritjen e saktë të pensioneve, dhe nuk u realizua edhe detyrimi, që inspektori përpunues të bëjë llogaritjet e sakta e të plota konform ligjit.

Më tej në vijim, lidhur me Argumentin justifikues se vendimi për rishqyrtim pensioni, si akt administrativ (nëse ekziston) ka dalë në zbatim të vendimit gjyqësor..., dhe sipas rregullores së ISSH Drejtoria e Përfitimeve të ISSH, kryen kontrollin e plotë në çdo rast të të gjitha përfitimeve të caktuara për herë të parë dhe përfitimet e rishqyrtuara, me qëllim që ato të jenë të bazuara në ligj, përfitimi nga sigurimet shoqërore, si dhe lëvizja shpesh e dosjes nga DRSSH në ISSH për certifikim të vendimmarrjes, dhe se nga ISSH dhe DRSSH nuk ka pasur asnjë trajtim të diferencuar në lidhje me procedurën e ndjekur dhe në asnjë moment DRSSH nuk është bërë pengesë për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës dhe ka ndjekur procedurat në respektim të ligjeve, prapësojmë si vijon:

1. Argumentet e paraqitura, janë thjesht deklarative, janë të pabazuara në ligj, në fakte e në prova, madje ato janë një disinformim e në pavërtetësi të situatës që i paraqitet Komisionerit, lidhur me ekzistencën e shkakut të vërtetë të pezullimit të pensioneve. Shkaku i vërtetë nuk është zbatimi i vendimit, por në mënyrë të drejtpërdrejtë është presion, shqetësim, shantazh, një diskriminim i pastër ndaj nesh, ta zvarritë sa më shumë mosrespektimin e ligjeve dhe moszbatim të vendimit të Gjykatës për të më stresuar, lodhur, mërzhitur e për të hequr dorë nga ankesat e kërkesat në lidhje me pensionet, deri duke nxirur frikën e pasigurinë për tani e për të ardhmen.

2. Vendimi i Gjykatës, i pretenduar si argument kryesor justifikues, nuk është shkak ligjor për pezullimin e pensioneve periodike mujore të muajve Janar e Shkurt 2025, për arsye se:

i) Akti administrativ që duhet të nxirret nga DRSSH në zbatim të vendimit, është një akt me fuqi prapavepruese, (sipas germës “a” të nenit 105 të Kodit të Pr. Administrative), ku me vendimin e saj Gjykata ka ndryshuar vendimet nr. 3822/2011 dhe nr. 187/2011, lidhur me datën e fillimit të të drejtës së përfitimit të PKU dhe PSU më 17.6.2009, dhe kthimin e diferencave të mbajtura padrejtësisht si rezultat i keqzbatimit të ligjit, për periudhën 2 vjeçare, 17.6.2009-17.6.2011.

ii) Ky vendim me fuqi prapavepruese buron nga parimi i sigurisë juridike dhe mbrojtjes së pritshmërisë së ligjshme që burojnë nga Shteti i së Drejtës, ku vendimi i Gjykatës, si organ kompetent, “riparon” një situatë të paligjshme, të shkaktuar nga ISSH e DRSSH, në mosrespektim të ligjeve.

iii) Vendimi i Gjykatës, e për rrjedhojë dhe akti administrativ i DRSSH, në zbatim të tij, për rikuperimin e të drejtës së cenuar për periudhën 2 vjeçare të cilësuar, nuk ka fare-fare-fare lidhje shkakësore dhe nuk ka fare -fare-fare impakt, për pezullimin e pensionit, të llogaritur po nga ISSH e DRSSH, në nëntor 2013, i cili është vënë në vendin meritore në pajtim të plotë me ligjin. Kjo masë e këtyre pensioneve, për shkak të ligjit e VKM përkatëse, si dhe të dhënave personale, është në kufijtë maksimal të kohës, dhe nuk mund t’i ndryshojë askush, as ndonjë dëshirë imja për më shumë, dhe as ndonjë dëshirë e ISSH e DRSSH për pakësim dhe as ndonjë gjykatë. Në këtë kënd vështrimi, bazuar në ligjet në fuqi, vendimi i Gjykatës, nuk përbën shkak ligjor të pezullimit, pasi

ky vendim nuk ka fare-fare-fare (zero) lidhje shkakësore me llogaritjen e pensioneve të caktuara në nëntor 2013, dhe që nga ajo kohë e deri më sot, ato pensione janë tërhequr periodikisht çdo muaj. Pra pezullim i dy pensione është haptazi i kundërligjshëm, një veprim ekstrem, i padrejtë, veprim çnjerëzor për më tepër i organi shtetëror publik, që nuk ndodh në asnjë vend të botës të mohohet pensioni, madje edhe kriminelëve u jepet bukë tre herë në ditë, deri para ekzekutimit me vdekje

iv) Nuk janë pensionet e paguara pengesë për moszbatimin e vendimit të gjykatës, pasi llogaritjet për periudhën në fjalë, bëhen fare-fare lehtë, ngaqë dhe për këtë periudhë, masa e pensioneve është po ajo e vitit 2011 apo 2013, që për të njëjtin ligj, kushte, po ato të dhëna personale është në kufirin “tavan”, pra në maksimum të përcaktuara në ligj dhe në VKM përkatëse, siç i ka përcaktuar ligjvënësi, për secilin pension, të pleqërisë dhe suplementar. Argumentet që sillen si justifikim, për rillogaritje, shqyrtim, rillogaritje, rishqyrtim, certifikim, ricertifikim, lëvizje dosjes, etj., janë jashtë logjikës juridike, për më tepër jashtë logjikës së shëndoshë, janë absurde, jo serioze dhe fare qesharake, që diskreditojnë këto organe, autoritete shtetërore të specializuar në fushën e sigurimeve shoqërore, që me veprime sjellje të tilla, passjellin pasoja rreziku deri pasiguri shoqërore prej tyre.

v) Nisur nga sa më sipër, qartësisht, e dukshëm, DRSSH, me veprimet e mosveprimet e saj në kundërshtim me Kushtetutën, KEDNJ, Deklaratën Universale për Mbrojtjen e të Drejtëve dhe Lirive Themelore të Njeriut, Kodin e Pr. Administrative, Kodin Etik të nëpunësit civil, Ligjin nr. 7703/93 të ndryshuar, Rregulloren Nr. 1/2008 të ISSH, Statusin e Ushtarakut të FA dhe ligjet materiale për sigurimin shoqëror suplementarë të ushtarakëve të FA në zbatim të tij, aktet nënligjore (VKM) në zbatim të ligjeve, ka konsumuar plotësisht sjelljen diskriminuese, me pezullimin e pensioneve për muajin Janar dhe Shkurt 2025, kjo sa për shkak të moshës së shkuar të pleqërisë, ndoshta dhe bindjeve politike, përkatësisë në armatën e ushtarakëve, si dhe veprimeve tendencioze të hakmarrjes, shantazhit, shqetësimit, e viktimizimit dhe për çdo shkak tjetër.

Argumentet, janë jo vetëm jashtë logjikës por edhe qesharake, për faktin tjetër, se vendimi nuk pengoi as ISSH, as DRSSH, që në 4 shkurt urdhëroi Agjencinë Postare nr. 24 të paguhet vetëm pensioni i pleqërisë. Por çuditërisht jo ai suplementar, i cili, si derivat i atij të pleqërisë apo më thjeshtë si pjesë e tij. Pa asnjë shkak ligjor u mbajt peng edhe për muajin Shkurt 2005. Pse u mbajt peng ky pension? Askush nuk jep asnjë përgjigje! Po ashtu, ky vendim, nuk pengohet fare as nga “Kërkesa për Sqarim....”, pasi ai duhej zbatuar menjëherë. Ka mjete ligjore nëse ka vend për ta kundërshtuar atë. Por ky vendim nuk i pengoi këto dy autoritete, për faktin se ato dhanë urdhër që në Mars të paguhen normalisht të dy pensionet, si dhe duke kthyer diferencat. Po dhe e kundërta, pagimi i pensioneve mujore, normalisht, nuk pengon fare që të bëjë jo vetëm llogaritje por dhe çdo veprim tjetër administrativ në marrëdhëniet midis këtyre dy autoriteteve publike.

Në këto kushte, kur vendimi, duket qartazi dhe haptazi që nuk është fare shkak ligjor për pezullimin e pensioneve, atëherë natyrshëm lindin pyetjet:

iii. Cilat janë shkaqet ligjore të ndalimi të dy pensioneve për muajt Janar dhe Shkurt 2025?

iv. Cilat janë shkaqe ligjore, që në shkurt u urdhërua Agjencia 4, të më paguajë vetëm pensionin e pleqërisë për muajin të dy muajt Janar dhe Shkurt?

v. Cilat janë shkaqet ligjore që u mbajt i pezulluar pensioni suplementar edhe më tej, për muajin Shkurt?

vi. Cilat janë shkaqet ligjore që lejuan që pensioni suplementar të jepej normalisht në mars 2025?

vii. Cilat janë shkaqet ligjore që çuan urdhërin Agjencisë 4 për pagimin normal të pensioneve në Mars e Prill?

Këto pyetje, nuk gjejnë përgjigje në informacionin “Kthim përgjigje”.

3. Këto fakte, provojnë se nuk është e vërtetë situata që paraqet DRSSH dhe ISSH, se pengon vendimi i Gjykatës, se kanë vështirësi, se nuk janë sqaruar nga Vendimi, se duhet certifikuar, e të tjera e të tjera. Kushdo qytetar, që lexon këtë “Kthim përgjigje” dhe që ka njohuritë më elementare për çështjen e jo më unë si pensionist jo analfabet në njohjen e ligjit të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga Kushtetuta dhe ligjet, e për më tepër një Jurist, do të arrijë në përfundimin e arsyeshëm, se këtu kemi të bëjmë me kompromentim të detyrës së punonjësve, të cilët shpërdorjnë detyrën e besuar, nuk i nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjit, por urdhërave politike të drejtuesve, kjo e pa deklaruar e shkruar gjëkund, por që shihen, ndjehet dhe provohet e vërtetohet realisht në jetën e përditshme, vërtetohet në veprimet e mosveprimeve të tyre, të reflektuara qartësisht në aktet e veta administrative apo në dokumente zyrtare, që pasojat e tyre cenojnë jetesën e pensionistëve, duke e përkeqësuar.

4. Kemi arsye të shprehemi, se qëndrimi i ISSH e DRSSH, për pezullimin e pensioneve, është “vërtetë” pengesë e shkak vendimi i Gjykatës, në këndvështrim tjetër, të padeklaruar prej tyre, por lehtësisht i kuptuar apo i nënkuptuar, ku këto dy autoritete, ndodhen në mënyrë të papritur, para vendimit të saj, sesi gjithmonë, që duke qenë autoritet shtetëror, në pozita superiore, ndaj pensionistit prishin që gjykata, kur ka gjyqtarë të korruptuar militantë partiakë, të lidhur me Ekzekutivin, pra të Shtetit, të vendosë kurdoherë në favor të tyre, do dalin gjyqfitues edhe kur shkelin ligjin dhe dhunojnë hapur të Drejtat dhe Liritë Themelore kushtetuese e ligjore e të qytetarëve pensionistë.

Në rastin konkret Gjykata, bazuar në ligj, fakte dhe prova të pakundërshtueshme, vendosi në favorin tim, pra, kundër veprimeve abuzive të DRSSH e ISSH, të shprehura qartësisht në përmbajtjen e vendimeve administrative përkatëse, apo në pretendimet e tyre të pabazuara në ligj, fakte e prova. Ato, dalin si të thuash zbuluar në veprimtarinë administrative që është hapur dhe dukshëm në kundërshtim me ligjin. Ndaj dhe pezullimi i pensioneve, është një veprim tendencioz hakmarrës për të shtirë frikë, pasiguri, sorollatje zyrave, lodhje, zvarritje që unë të heq dorë nga denoncimi në shtyp, në organet shtetërore a në gjykata të shkeljeve që kryejnë punonjësit e ISSH e DRSSH, kryesisht në rastin personal, apo edhe për raste të ngjashme për kolegët ushtarakë. Pra edhe në këtë rast, kemi një diskriminim të skajshëm, të drejtpërdrejtë ku DRSSH fsheh e paraqet një situatë të gënjeshtër, të stisur, te pavërtetë edhe Komisionerit, lidhur me situatën aktuale aty.

5. Argumentet, që ka zgjedhur si justifikim DRSSH lidhur me zbatimin e të famshmit vendim të Gjykatës, janë një përpjekje tepër e sforcuar për të mbuluar e fshehur të vërtetën, edhe për faktin tjetër domethënës, të tejkalimit të skajshëm të afatit të kësaj llogaritjes (4 muaj), dhe faktit

tjetër që edhe pse qenka ricertifikuar nga ISSH, ende s'është zbatuar vendimi i Gjykatës, pse? Dhe nuk dihet nëse do zbatohet, apo jo. Fakti që dhe në muajin prill unë kam tërhequr pensionet (të pleqërisë dhe suplementar së bashku) pa pengesë e normalisht, sikurse para Janarit, pra në Dhjetor 2024, e përforcon më tej prapësimin tonë se vendimi i Gjykatës nuk ka penguar dhe nuk pengon pagimin normal të pensioneve. Përkundër pretendimit të DRSSH, as tërheqja normale apo as pezullimi i pensioneve nuk ndikon në çdo veprim apo llogaritjen në kohë e me saktësi të këtyre pensioneve për periudhën e shkuar 17.6.2009-17.6.2011 si dhe të diferencave të papaguara.

6. Sikurse theksuam dhe që dihet, ndërsa Vendimi i Gjykatës së Apelit është favorizues për mua, pra kthimin e diferencave të mbajtura paligjshmërisht prej DRSSH për periudhën 17.6.2009-17.6.2011. Po kjo nuk ka lidhje me pensionin aktual që marr. Në mënyrë të paimagjinueshme, të pa pritur, nga DRRSH, në vend që të më kthejë lekët e mbajtura, më ndalon të marr normalisht edhe atë mizerabël pension, duke më lënë pa bukë e ilaçe, pa shërbime, më rrezikon JETËN.

Siç dihet, prekja, kufizimi apo shuarja e një të drejtë themelore e interesi kushtetues e ligjor bëhet vetëm me ligj, konform dispozitave të Kushtetutës, Konventës, Kodit Pr. Administrative dhe ligjeve të tjera në fuqi. Aktualisht, pezullimi i pensioneve, pa asnjë shkak ligjor, nuk justifikohet objektivisht dhe ky pezullim nuk ndjek një synim apo qëllim të ligjshëm, por është në mënyrë më ekstreme këto organe, qartazi e dukshëm bëhen dhunuese e diskriminuese të pensionistit.

Edhe pse pretendohet se pezullimi është bërë për shkak të vendimit, kjo nuk justifikohet dhe është jashtë logjikës juridike, absurde, anormale, pasi vendimi i Gjykatës, nuk thotë kurrë, t'i pezullohet pensioni, por t'i shtohen atij edhe ato diferenca të mbajtura në të kaluarën për shkak të veprimeve të paligjshme të DRSSH. Pezullimi, sipas Kushtetutës dhe Ligjit, është akti më ekstrem, veç që nuk ka shkak ligjor, ai nuk ndjek një synim e qëllimit të ligjshëm dhe nuk janë përdorur mjetet e përshtatshme dhe proporcionale të domosdoshme, konform ligjit e rregullave, për arritjen e atij synimi për të cilën është bërë pezullimi. Këtu diskriminimi, për nga natyra pasojat e pezullimit të pensioneve, si i vetmi burim financiar konstatohet lehtësisht se ai është diskriminim i drejtpërdrejtë, i dukshëm, i ndjeshëm, i papranueshëm dhe i patolerueshëm, dhe i dënueshëm.

7. I theksoj Komisionerit se nuk ndjehem aspak komod, që unë, pensionisti në prag fund jete, t'i mësoj zyrtarëve të ISSH e DRSSH, shqipen, aritmetikën dhe ligjin, në fushën e ushtrimit të detyrës funksionale, dhe as organeve të tjera, përfshi dhe Institucioni tuaj. Por kurrsesi nuk mund të hesht dhe të pranoj, nga organet shtetërore publike shkeljen, dhunimin e diskriminimin lidhur me të drejtat themelore kushtetuese dhe interesat e ligjshëm, që më garanton Kushtetuta dhe Ligjet në fuqi, për t'i gëzuar ato në qetësi, normalitet, siguri e me dinjitet e jo të nëpërkëmbem e të diskriminohem. Ndaj u ankova pranë Komisionerit, për garantimin e Mbrojtjes nga Diskriminimi.

8. Të jem i sinqertë e transparent me Komisionerin, për shkak të ndjekjes nga afër së një periudhe të gjatë të veprimtarisë së ISSH e DRSSH, për trajtimin që më ka bërë në fushën e pensioneve, deklaroj haptazi se kam humbur tërësisht besimin tek këto dy organe, madje jo vetëm s'kam besim, por ndjej neveri, për plagët e vuajtjet që më kanë shkaktuar me sjelljen e aktet e tyre administrative, haptazi, dukshëm në kundërshtim me të gjithë kuadrin ligjor që ekziston në vend.

9. Nuk është detyra imja t'u ritheksoj dispozitat e Ligjeve të shënuara në Bazën Ligjor e të Ankesës, lidhur me pensionet e sidomos ato të Kuadrit Ligjor të Ushtarakëve.

Dihet se PENSIONI është një e Drejtë Themelore e Njeriut, që ka të bëjë me JETËN, jo vetëm njohur dhe mbrojtur nga Kushtetuta, nga KEDNJ, por edhe nga Deklarata Universale mbi të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, si dhe nga i gjithë Kuadri Ligjor i zbatueshëm në fuqi. Ajo që dua të theksoj Komisionerit se, veçanërisht pensionet suplementare të ushtarakëve të FA të RSH, për vetë misionin dhe funksionin kushtetues të FA, gëzojnë një mbrojtje specifike nga Legjislacioni ynë, i cili duhet të zbatohet, por që realisht, për fat të keq, në praktikë, nuk është zbatuar e ende nuk po zbatohet si duhet, sikurse parashikojnë ligjet.

Një trajtim kompetent, të hollësishëm dhe shterues për një kuptim më të qartë dhe zbatimin e Statusit të Ushtarakut dhe Ligjeve në Zbatim të tij, i ka bërë Gjykata Kushtetuese në vendimet e posaçme nr. 9/2007 dhe nr. 33/2010. Për fat të keq, jo vetëm këto vendime, por edhe i gjithë kuadri ligjor për Ushtarakët nga viti 2000-2025 nuk është zbatuar me korrektësi nga ISSH dhe DRSSH, por me mangësi të mëdha, ndaj ato kane sjelle pasoja të rënda duke varfëruar pa shkak të arsyeshëm e objektiv pensionistët ushtarake. Ato janë zbatuar pjesërisht vetëm nëpërmjet vendimeve të Gjykatave, ku, siç kemi theksuar, falë mjaft gjyqtarëve me integritet moral dhe profesionalizëm të lartë, që me guxim e kurajo përballuan presionet e të gjitha pushteteve dhe u kanë dhënë të drejtë mbi 5 mijë ushtarakëve. Të tjerët, kanë mbetur jetimë, pa mbrojtje, pa mbështetje, pa kujdesje nga që organet ligjzbatuese, për shkaqe që dihen lidhur me mangësitë në funksionimin e Shtetit Ligjor në vend, të Sistemit të Drejtësisë, mangësi këto të njohura edhe ndërkombëtarisht, për shkak të korrupsioni të lartë galopant, kudo, ende nuk krijon mundësi për realizimin e të drejtëve e interesave kushtetuese e ligjore të qytetarëve e në këtë kuadër edhe ato të ushtarakëve, e midis tyre edhe unë si pjesëtar...”.

3. Në këto kushte, për administrimin e plotë të informacionit të kërkuar, për një gjykim sa më të drejtë dhe objektiv të çështjes, si dhe në zbatim të parimit të barazisë për një proces të rregullt ligjor, Komisioneri vlerësoi të nevojshme realizimin e seancës dëgjimore mes palëve. Në këtë kuptim me anë të shkresës nr. 349/5 prot., datë 30.04.2025 “Njoftim për seancë dëgjimore”, Komisioneri njoftoi palët lidhur me zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 14.05.2025.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Seanca u zhvillua në datë 14.05.2025, me praninë e: subjektit ankues, I. I.; palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësueseve të ISSH-së dhe DRSSH-së Tiranë, me autorizim.

Gjatë seancës dëgjimore, palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Përsa ka pretenduar edhe në ankesë, fillimisht I. I. gjatë seancës dëgjimore theksoi se kërkon nga Komisioneri të shqyrtojë vetëm ndërprerjen e pensionit pas daljes së vendimit të gjykatës. Gjithashtu, sqaroi se në asnjë moment nuk është njoftuar nga ana e përfaqësuesve të DRSSH-së

Tiranë apo ISSH-së lidhur me vonesat që do të krijoheshin si pasojë e zbatimit të vendimit të gjykatës për rillogaritjen e masës së pensionit. Megjithatë, në vijim u ra dakord nga palët që ankuesi është informuar për ndërprerjen e pensionit për shkak të rishqyrtimit të tij si pasojë e vendimit të gjykatës. Sakaq, nga palët u theksua se më datë 05.05.2025, është zbatuar i plotë vendimi i gjykatës nga ana e ISSH-së dhe DRSSH-së Tiranë. Ndërsa pensionin e pleqërisë ka vijuar ta marrë nga data 04.02.2025 e në vijim.

Nga ana e përfaqësuesve të ISSH-së dhe DRSSH-së Tiranë, u theksua ndër të tjera se vonesat janë krijuar për shkak të një paqartësie në vendimin e gjykatës, si dhe si rezultat i rishqyrtimit të pensionit në zbatim të tij. Sipas tyre nuk ka qenë në qëllimin e institucioneve ndërprerja e pensionit, por është pezulluar pas vendimmarrjes së gjykatës deri në rillogaritjen tij.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë.

Faktet dhe rrethanat e çështjes.

Bazuar në informacionin dhe aktet e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi se, ankuesi shërbyer si ushtarak (Oficer) në Forcat e Armatosura (FA), nga data 04.11.1970 deri më 30.09.1992. Për shkak të reformës në ushtri, më 30.09.1992 ka kaluar në rezervë. Nga kjo datë deri më 21.12.1995 është trajtuar me pagesë kalimtare nga Ministria e Mbrojtjes ku shërbente. Pas kësaj date, më 01.01.1996 është nxjerrë në lirim për të përfituar pension të parakohshëm.

Në bazë të ligjit nr. 8087/1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të FA të RSH”, i ndryshuar, ankuesit i ka lindur e drejta e trajtimit me pension të parakohshëm për vjetërsi të shërbimit të ushtarakut. Lidhur me këtë, DRSSH Tiranë, me Vendimin nr. 1477, datë 17.02.2000, i ka caktuar ankuesit pension të parakohshëm në masën 8000 lekë, me të drejtë fillimi më 01.01.1999 dhe mbarim më datë 17.06.2006.

Duke mos rënë dakord me masën e pensionit të parakohshëm, ankuesi i është drejtuar Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt shfuqizimin e Vendimit nr. 1477, datë 17.02.2000. Me vendimin nr. 1749, datë 07.02.2014 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vendosur: “Shpalljen e moskompetencës lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për gjykimin e çështjes nr. 1384 akti. Dërgimin e çështjes dhe akteve shoqëruese, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 3508, datë 24.06.2014, ka vendosur: “Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë me paditës I. I.n, e paditur Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, duke detyruar palën e paditur që të rillogarisë dhe të përcaktojë

masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, në masën 50% të pagës referuese së bashku me shtesat 2% për çdo vit të vjetërsisë në shërbim mbi 15 vjet duke aplikuar rritjet e përvitshme sipas VKM-ve respektive si dhe pagimin e diferencave të rezultuara nga data e lindjes së të drejtës deri në datën 01.07.2009. Rrëzimin e kërimit të pagimit të diferencave nga data 01.07.2009- 16.06.2011, si të pabazuar në prova dhe në ligj”.

Kundër këtij vendimi, I. I. dhe Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë kanë paraqitur ankim pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ku kjo e fundit me vendimin me nr. 2418, date 27.07.2016, ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr. 3508, datë 24.06.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Pranimin e pjesshëm të kërkesë-padisë. Detyrimin e palës së paditur DRSSH Tiranë ti paguajë paditësit shumën prej 294.694 lekë si diferencë e papaguar për periudhën 13.05.2004-30.06.2009. Rrëzimin e padisë në lidhje me kërkimet e tjera si të pabazuar në ligj”.*

Në zbatim të titullit ekzekutiv, DRSSH Tiranë me vendimin datë 05.10.2016 ka rillogaritur përfitimin e kërkuarit sipas përcaktimeve në dispozitivin e vendimit të Gjykatës duke rillogaritur diferencat e pensionit për periudhën 13.05.2004-30.06.2009 në shumën 294.694 lekë në total. Diferenca të cilat I. I. i kanë kaluar pranë Qendrës paguese më datë 05.10.2016.

Sipas, DRSSH-së Tiranë, njohja e të drejtës së diferencave deri më datë 30.06.2009 nga ana e gjykatës, është bërë shkak se në maj të vitit 2009, është miratuar ligji nr. 10142, datë 15.05.2009 *“Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm”*, i cili i shtrinte efektet financiare nga data 01.07.2009. Ky ligj, citon DRSSH Tiranë, parashikonte skemë llogaritjeje të ndryshme dhe masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi ndryshoi sërish.

Në këto kushte, DRSSH Tiranë ka bërë rillogaritjen e pensionit të parakohshëm të I. I.. Sipas vendimit për rishqyrtim pensioni nr. 1477, datë 22.04.2014, masa e pensionit të ankuesit i është ulur në 10.278 lekë në muaj me të drejtë pagese nga data 01.07.2009 (nga data që ka hyrë në fuqi ligji nr. 10142/2009), deri më datë 17.06.2011 (datë që ankuesi ka mbushur moshën e pensionit të pleqërisë).

DRSSH Tiranë, në zbatim të nenit 31, 32, 92, të ligjit nr. 7703/1993 *“Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar, me vendimin për caktim pensioni nr. 3822, datë 25.07.2011, i ka caktuar I. I. pension të plotë pleqërie me 40 vite e 5 muaj periudhë sigurimi, me të drejtë pagese nga data 17.06.2011, me masë fillestare 12.191 leke në muaj.

Pensioni është rillogaritur në datë 20.09.2011, me pagat referuese sipas funksionit të kryer ndër vite, të përcaktuara në VKM nr. 561, datë 12.08.2005 *“Për caktimin e pagave referuese për llogaritjen e pensioneve”*, lloji i punës “Oficer”, me koeficientët e vitit 2011, me bazë mesatare mujore 25.378 lekë, pagë neto 26.301 lekë, me periudhë sigurimi 41 vite e 9 muaj dhe me masë pensioni 19.726 lekë në muaj.

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 793, datë 24.09.2010 *“Për zbatimin e ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakeve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, në Republikën e Shqipërisë”*, pensioni i pleqërisë është rishqyrtuar me datë fillimi 17.06.2011, me masë pensioni 21,380 leke në muaj. Sipas DRSSH-së, përfitimi është llogaritur që nga momenti që I. I. ka plotësuar kushtet për përfitim, në zbatim të nenit 32 të ligjit nr. 7703/1993, të ndryshuar, ku parashikohet:

“1. Pensioni mujor i pleqërisë përbëhet nga një shumë bazë dhe nga një shtesë.

2. Shuma bazë e pensionit që u jepet gjithë personave të siguruar, duhet të sigurojë të paktën një standard jetese minimal, i indeksuar çdo vit në lidhje me indeksin e çmimeve të disa mallrave të zgjedhura, të përcaktuara në rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

3. Shtesa që u jepet personave të punësuar, do të jetë 1 për qind për vit sigurimi shumëzuar me bazën mesatare të vlerësueshme që personat e siguruar kanë arritur nëpërmjet kontributeve. Këshilli i Ministrave të indeksojë çdo vit bazën e vlerësimit individual në lidhje me zhvillimin e kontributeve mesatare të paguara në këtë vit.

4. Shuma e përgjithshme e pensionit do të jetë jo më shumë se dyfishi i shumës bazë, ose 75 përqind e pagës neto mesatare të 3 viteve rresht të 10 viteve të fundit të punës të personit të siguruar, cila të jetë më e vogël.

Paga neto mesatare e 3 viteve të njëpasnjëshme të 10 viteve të fundit të punës së personit të siguruar, indeksohet çdo vit, sipas rregullave të indeksimit të bazës së vlerësuar.”

Nga ana e DRSSH-së Tiranë, masa e pensionit të I. I. është caktuar në nivelin maksimal të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në lidhje me pretendimin për rishikimin e datës së daljes në pension, në kushtet e kategorisë së dytë të punës, të parashikuara në nenin 92 të ligjit nr. 7703/1993, të ndryshuar, I. I. është informuar nga ana e DRSSH-së se nuk ka plotësuar kushtet për këtë lloj përfitimi.

I. I. nuk ka qenë dakord me përfitimin e caktuar dhe ka vijuar me ankimin administrativ. Komisioni Rajonal i Ankimit pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, me vendimin nr. 32, datë 11.03.2016, ka vendosur të rrezojë kërkesën për caktimin e pensionit të pleqërisë në kushtet e kategorisë së dytë të punës, që nga data 17.06.2009 deri në 17.06.2011. Komisioni Qendror i Ankimit pranë ISSH-së, me vendimin nr. 946, datë 20.06.2016, ka vendosur të rrezojë kërkesën

për caktimin e pensionit të pleqërisë në kushtet e kategorisë së dytë të punës dhe të lërë në fuqi vendimin e DRSSH-së Tiranë dhe vendimin nr. 32, datë 11.03.2016, të Komisionit Rajonal të Ankimit pranë DRSSH-së Tiranë.

Neni 86 i ligjit nr. 7703/1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon se: “

1. *Ankimi kundër vendimeve të përfitimeve bëhet në Komisionin e Ankimit pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore. Ankimi, në këto raste, depozitohet pranë sporteleve të shërbimit, në përputhje me legjislacionin që rregullon mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel.*
2. *Ankimi kundër vendimeve të Komisionit të Ankimit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore bëhet në Komisionin e Ankimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore;*
3. *Ankimet e zgjidhura në mënyrë të pafavorshme bëhen në Gjykatë, vendimi i të cilës është përfundimtar;”*

Në vijim I. I. i është drejtuar gjykatës dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 762, datë 28.02.2017, ka vendosur: Rrëzimin e padisë së paditësit I. I.. Kundër këtij vendimi I. I., si palë paditëse, ka bërë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, me shkresën nr. 29636/3 prot, datë 04.12.2024, është njoftuar nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë për vendimin nr. 1885, datë 11.11.2024, me palë paditëse I. I. dhe të paditur: DRSSH Tiranë dhe ISSH, ku është vendosur:

- *Ndryshimin e vendimit nr. 762, datë 28.02.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*
- *Pranimin pjesërisht të padisë.*
- *Ndryshimin pjesërisht të vendimit nr. 3882, datë 25.07.2011 dhe të vendimit nr. 187, datë 15.12.2011 të DRSSH Tiranë lidhur me datën e fillimit të së drejtës për pension pleqërie dhe suplementar nga data 16.06.2011 në datën 17.06.2009.*
- *Detyrimin e palës së paditur DRSSH Tiranë ti paguajë paditësit diferencat e pensionit të pleqërisë dhe atij suplementar të indeksuara sipas viteve për periudhën 17.06.2009-16.06.2011.*
- *Rrëzimin e padisë, për pjesën tjetër si të pabazuar në prova dhe në ligj.*
- *Ky vendim përbën titull ekzekutiv dhe është i ekzekutueshëm nga përmbaruesi gjyqësor.*
- *Kundër këtij vendimi lejohet rekurs brenda 30 ditëve në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.*

Mbështetur në parashtrimet e paraqitura nga I. I. gjatë procedurave të shqyrtimit të ankesës, ai ka pretenduar diskriminimin lidhur me veprimet dhe mosveprimet e ISSH-së dhe DRSSH-së, sa i përket 2 (dy) momenteve: atë të ndërprerjes së pensionit për shkak të rishqyrtimit në zbatim të

vendimit nr. 1885, datë 11.11.2024, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe faktin që nuk është informuar mbi këtë procedurë.

Sa i përket efekteve dhe procedurave të ndjekura nga ISSH dhe DRSSH-të, Grupi i Menaxhimit Strategjik, i ngritur pranë ISSH-së, ka miratuar Vendimin nr. 03, datë 08.02.2022 *“Për shtrirjen e efekteve të vendimeve gjyqësore të formës së prerë në përfitimet e sistemit të sigurimeve shoqërore”*. Në pikën 8, të këtij dokumenti, parashikohet se: *“Vlerat kreditore të llogaritura në zbatim të këtij vendimi, nuk gjenerohen për pagesë në sistemin PCAMS, pa u vlerësuar ligjshmëria e vendimmarrjes nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve (në vijim NJIP), sipas hapave të mëposhtëm:*

- a) punonjësit përgjegjës në DRSSH/DSSH, kryejnë të gjitha veprimet procedurale të parashikuara në legjislacionin e zbatueshëm deri në fazën e gjenerimit të pagesës së vlerës kreditore në zbatim të vendimit të gjykatës dhe e dërgojnë dosjen menjëherë për vlerësim në NJIP në ISSH;*
- b) NJIP brenda 5 ditëve pune, vlerëson ligjshmërinë e vendimmarrjes në zbatim të vendimit të gjykatës dhe e dërgon dosjen për veprime të mëtejshme në DRSSH/DSSH;*
- c) DRSSH/DSSH kalon menjëherë për pagesë në sistemin PCAMS, vlerën kreditore kur vendimi është vlerësuar i rregullt nga NJIP;*
- ç) nëse NJIP nuk e ka vlerësuar të rregullt vendimin, DRSSH zbaton rekomandimet përkatëse dhe e dërgon dosjen sërish për vlerësim.”*

Së pari, fillimisht do të analizohet procedura e ndërprerjes së pensionit për shkak të rishqyrtimit të masës në zbatim të Vendimit nr. 1885, datë 11.11.2024, të Gjykatës Administrative të Apelit. Sakaq, në zbatim të vendimit të sipërpërmendur, Dega Juridike e DRSSH Tiranë me shkresën nr. 29636/5 prot., datë 05.12.2024, i ka përcjellë Degës së Përfitimeve, Sektorit Suplementar vendimin nr. 1885, datë 11.11.2024, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Dega e Përfitimeve pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, me vendimin për rishqyrtim pensioni me nr. 3882/4, datë 10.12.2024, ka përllogaritur diferencat e pensionit të pleqërisë nga data 17.06.2009 - 16.06.2011, në vlerën totale 503.705 lekë.

Gjithashtu, mbështetur në informacionin e administruar, sipas vendimit për rishqyrtim pensioni nr. D, datë 23.12.2024, është përllogaritur pensioni suplementar dhe ka rezultuar se me vendim nr. 1477, datë 17.02.2000, I. I. ka përfituar pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi me të drejtë pagese nga data 01.01.1999-17.06.2011. Për periudhën 17.06.2009-16.06.2011, që është trajtuar me pension të parakohshëm ka përfituar shumën 300.792 lekë dhe në kushtet që gjykata i ka njohur të drejtën e pensionit suplementar të pleqërisë për periudhën 17.06.2009-16.06.2011, janë llogaritur diferencat në vlerën 251.580 lekë. Nga DRSSH Tiranë, është bërë diferenca kredi-debi dhe ka rezultuar debitor në vlerën 49.176 lekë.

Pas kryerjes së të gjithë procedurës nga Dega e Përfitimeve pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, për zbatimin e vendimit të sipërcituar, dosja është dërguar në Drejtorinë e Inspektimit të Përfitimeve pranë Institutin e Sigurimeve Shoqërore, për vlerësimin e ligjshmërisë të caktimit të përfitimit.

Në procesin e vlerësimit të dosjes, nga ana e Drejtorisë së Inspektimit të Përfitimeve, të ISSH-së, janë hasur vështirësi për zbatimin e titullit ekzekutiv pasi gjykata në arsyetimin e vendimit është shprehur në mënyrë kontradiktore si më poshtë: *“Në analizë përfundimtare të ligjit dhe fakteve të provuara në gjykim, Kolegji vlerëson se aktet administrative objekt gjykimi: Vendimi nr. 3882, datë 25.07.2011 dhe vendimi nr. 187, datë 15.12.2011, të DRSSH-së Tiranë, duhet të ndryshohen pjesërisht hidhur me datën e fillimit të së drejtës për pension pleqërie dhe suplementar nga data 16.06.2011, në datën 17.06.2009. Për pasojë, pala e paditur DRSSH Tiranë, ka detyrimin t’i paguajë paditësit diferencat e pensionit të pleqërisë dhe suplementar të indeksuara sipas viteve për këtë periudhë (17.06.2009-16.06.2011). Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se pretendimi i dytë i paditësit se duhet t’i caktohet pension i kategorisë së dytë dhe jo i kategorisë të tretë, siç i është caktuar nga DRSSH Tiranë, është i pabazuar në ligj dhe si i tillë duhet rrëzuar”.*

Gjykata në dispozitivin e vendimit sipërcituar ka vendosur: *“Detyrimin e palës së paditur DRSSH Tiranë t’i paguajë paditësit diferencat e pensionit të pleqërisë dhe atij suplementar të indeksuara sipas viteve për periudhën 17.06.2009-16.06.2011”.*

Duke iu referuar nenit 92 të ligjit nr. 7703/1993 *“Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar dhe nenit 23 të ligjit nr. 10142/2009 *Për Sigurimin Shoqëror Suplementar të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë të Mbrojtjes, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të Punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar, sipas vlerësimit të bërë nga ana e DRSSH Tiranë, rezulton se data e lindjes së të drejtës për pension të kategorisë së tretë është data 16.06.2011, ndërsa gjykata ka vendosur t’i paguhen diferencat nga data 17.06.2009, edhe pse pretendimi për pension të kategorisë së dytë në fakt e ka rrëzuar dhe pensioni mund të fillonte nga kjo datë vetëm nëse ky pretendim do të ishte pranuar. Në këto kushte, dosja është kthyer me shkresë nr. 12834/1 prot., datë 23.01.2025, nga Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve, me detyrë që DRSSH Tiranë të bëjë kërkesë për sqarim dhe interpretim vendimi pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Po në të njëjtën datë, më 23.01.2025, Drejtoria Juridike e DRSSH Tiranë, i është drejtuar me kërkesë për sqarimin dhe interpretimin e vendimit nr. 1885, datë 11.11.2024, Gjykatës Administrative të Apelit.

Ndërkohë, gjatë kësaj periudhe, I. I. i është drejtuar Zyrës Përmbaremore Tiranë, e cila me shkresën datë 17.01.2025, i është drejtuar DRSSH-së Tiranë (protokolluar pranë DRSSH-së me nr. 29636/9 prot., datë 20.01.2025) duke kërkuar ekzekutimin vullnetar vendimit nr. 1885, dt. 11.11.2024, te Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Lidhur me këtë, me shkresën nr. 29636/11 prot., datë 23.01.2025, DRSSH Tiranë ka informuar Zyrën Përmbaremore Tiranë lidhur me pamundësitë e ekzekutimit të vendimit të gjykatës dhe procedurat e ndjekura prej tyre për shqyrtimin e dosjes së I. I..

Në këto kushte, Zyra Përmbaremore Tiranë me shkresën nr. 1534 prot., datë 03.02.2025, me kërkesë të I. I., ka vendosur “Pushimin e Urdhrit të Ekzekutimit”.

Në vijim, DRSSH Tiranë, është njoftuar nga zyra përmbaremore private E.G. BAILIFF SERVICE, e cila me shkresën nr. 762/1 prot., datë 03.03.2025 “Lajmërim për Ekzekutim të Detyrueshëm”, ka kërkuar ekzekutimin e vendimit nr. 1885, dt. 11.11.2024, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, me shkresën nr. 29636/19 prot., datë 11.03.2025, i ka kthyer përgjigje zyrtare, duke i vënë në dispozicion përmbaremit gjyqësor të zyrës përmbaremore private E.G. BAILIFF SERVICE të gjithë praktikën e mbajtur nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, mbi mënyrën e përlllogaritjes së diferencave të pensionit të pleqërisë dhe suplementar dhe për “Kërkesën për sqarim dhe interpretim vendimi”, drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Ndërkohë, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 40, datë 12.02.2025, ka vendosur: “*Rrëzimin e kërkesës së Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë*”, vendim për të cilin ka marrë dijeni me njoftimin nr. 29636/20 prot., datë 11.03.2025. DRSSH Tiranë me shkresën nr. 29636/21 prot., datë 12.03.2025, ka ridërguar dosjen përsëri për certifikim. Sakaq, Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve pranë ISSH-së, ka certifikuar dosjen e përfitimit të I. I. dhe e ka dërguar pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, më datë 22.03.2025 për të vijuar me procedurat.

Pas certifikimit të dosjes nga Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve të ISSH-së, sipas informacionit të administruar, DRSSH Tiranë nga muaji Mars 2025, i ka kaluar I. I. pensionin e plotë të pleqërisë dhe pagesat e prapambetura. Ndërkohë, në muajin Maj 2025, ankuesit i janë shlyer të gjitha detyrimet nga ana e DRSSH-së Tiranë, në zbatim të vendimit nr. 1885, datë 11.11.2024, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Në analizë sa më sipër, evidentohet se dosja e përfitimit të ankuesit ka qenë në proces shqyrtimi administrativ dhe vonesa e pagesës së përfitimit për muajt Janar dhe Shkurt, ka ardhur si pasojë e procedurës së ndjekur dhe kërkesës së bërë nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë për sqarim interpretim të vendimit të gjykatës. Nga informacioni i administruar, ISSH dhe

DRSSH Tiranë, kanë ndjekur të njëjtën procedurë për rishqyrtimin e masës së pensionit në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë edhe në raste të tjera të ngjashme.

Megjithatë, në rregulloren nr. 1, datë 21.10.2008 *“Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”*, miratuar nga Këshilli Administrativ i ISSH-së, në pikën VIII parashikohen *“Rregullat dhe procedurat për ndryshimin, pezullimin dhe mbylljen e pensionit”*. Në pikën VIII/c, përcaktohen rastet kur pezullohet pensionet, ku përcaktohet se:

“1. Pezullimi i pensionit bëhet në çdo kohë gjatë së cilës është duke u përfituar pensioni dhe mbi bazën e fakteve që cenojnë legjitimitetin e tij.

2. Pezullimi bëhet:

- Në rastet kur Drejtori i Përgjithshëm i ISSH-së dhe drejtori i DRSSH-së kanë fakte ose sinjalizime, kanë të drejtë të pezullojnë pensionin, mbi bazën e kontrolleve ose rikontrolleve të urdhëruara prej tyre.*
- Kur nga auditimi i dosjes nga audit i ISSH-së dhe audit i DRSSH-së rezulton që pensioni është caktuar në kundërshtim me dispozitat ligjore, vendimet, udhëzimet dhe rregulloret në fuqi.*
- Kur dosja kërkohet për shqyrtim në KMCAP-epror.*
- Kur pensioni nuk tërhiqet për një periudhë mbi një vit. Në këtë rast mund të hartohet edhe urdhërmbyllje e urdhërpaguesë dhe bëhen veprime edhe në programin e kartelizimit dhe në «exel» dhe si postë paguese do të bëhet shënimi postë paguese në konservim. Ky shënim do të vendoset edhe nga inspektori përpunues në dosjen e pensionit.*

3. Pezullimi i pensionit bëhet për aq kohë sa kërkohet për verifikimin për faktet që kanë dalë deri në nxjerrjen e urdhrit për mbylljen e pensionit ose urdhrit për pagesën e tij.

4. Kur merret vendim për mbylljen e pensionit, atëherë përpilohet urdhërmbyllja e pensionit sipas procedurave të përcaktuara më lart.

5. Urdhri i pezullimit të pensionit i dërgohet qendrës paguese nga dega e financës.

6. Njoftohet personi i interesuar për pezullimin e pensionit. Me marrjen e njoftimit, personi i interesuar paraqitet në DRSSH dhe nga inspektori përpunues hartohet procesverbal për shkaqet e pezullimit. Me plotësimin e dokumenteve në bazë të procesverbalit, fillon rishqyrtimi i pensionit sipas procedurave të përcaktuara në këtë rregullore.

7. Inspektori përpunues, përveç llogaritjes së pensionit sipas procedurave më lart, llogarit edhe masën e pensionit, bën diferencat midis masës së përfituar dhe shumës që duhet të kthejë dhe ia paraqet degës së financës për sistemim e kontabilizim të veprimeve kontabël dhe arkëtimin e tyre”.

Mbështetur në informacionin e administruar, evidentohet se ISSH dhe DRSSH, nuk kanë dalë me një akt administrativ apo dokument përmes së cilit është vendosur pezullimi i pensionit për një shkak apo afat të caktuar. Sakaq, evidentohet se vonesat e krijuara kanë ardhur si pasojë e zbatimit të plotë të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

Në analizë sa më sipër cituar dhe parashtrimet e vëna në dispozicion nga palët, nuk rezulton që të jetë parashikuar ndonjë akt ligjor apo nën ligjor, për mënyrën se si veprohet nga ana e strukturave

të sigurimeve shoqërore, në rastet e zbatimit të vendimeve të gjykatave për rillogaritjen e masës së pensionit. Pavarësisht këtij fakti, Komisioneri konstaton se ndalesa e masës së pensionit për të moshuarit përbën një shkëlqje të drejtave të tyre themelore, duke i vendosur ata në kushte të pafavorshme në raport me pjesën tjetër të shoqërisë. Kjo praktikë cenon parimet e barazisë dhe të mbrojtjes së posaçme që shteti është i detyruar të garantojë ndaj shtresave vulnerabël, siç janë të moshuarit. Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se ndalimi i përfitimit të masës së pensionit përbën një ndërhyrje disproporcionale dhe të pajustificuar, që bie ndesh me standardet e mbrojtjes sociale dhe barazisë para ligjit.

Për shumicën e të moshuarve, pensioni përfaqëson të vetmen burim të ardhurash për përballimin e nevojave jetike, dhe çdo ndërprerje apo pezullim i tij cenon rëndë dinjitetin dhe mirëqenien e këtij grupi shoqëror. Në këtë kuadër, ndalesa e masës së pensionit konsiderohet si një ndërhyrje e pajustificuar dhe disproporcionale, në kundërshtim me parimet e barazisë, të mbrojtjes sociale dhe të trajtimit të barabartë para ligjit. Komisioneri thekson se autoritetet përkatëse, ISSH dhe DRSSH Tiranë në rastin konkret, kanë detyrimin të sigurojnë një mbrojtje efektive dhe të pandërprerë për pensionistët, duke mos cenuar të vetmen të ardhur që ata disponojnë.

Nga ana e ISSH-së dhe DRSSH-së, në rastin konkret, mund të ishte vijuar me procedurën e rillogaritjes së masës së pensionit të pleqërisë dhe atij suplementar, por të mos i ishte ndërprerë ankuesit pensioni mujor i pleqërisë, duke iu cenuar i vetmi burim të ardhurash që ai ka.

Së dyti, lidhur pretendimin e ankuesit se nuk është informuar mbi këtë procedurë dhe pezullimin e pensionit, gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar pranë Komisionerit, nga ana e palëve në proces u pranua se ata kanë mbajtur komunikim të vazhdueshëm sa i përket problematikës së krijuar. Gjithashtu, referuar informacionit të administruar, ankuesi ka mbajtur një komunikim edhe nëpërmjet e-mail-eve zyrtare me përfaqësues të DRSSH-së Tiranë, në datat 24.12.2024 dhe 07.01.2025, përmes së cilave është informuar mbi procedurat e rishqyrtimit të pensionit të pleqërisë.

Në këto kushte provohet se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme sa i përket ndalesës së pensionit për muajt Janar dhe Shkurt 2025, duke i cenuar të vetmin burim të ardhurash për përballimin e nevojave jetike.

Në përfundim, Komisioneri arrin në përfundimin se, subjekti ankues, është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme gjatë procedurës së rillogaritjes së masës së pensionit.

B. Shkaku i mbrojtur

Mbështetur në nenin 2⁸, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ky ligj, ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Ankuesi pretendon se është diskriminuar për shkak të “moshës” dhe “për shkak të ankimeve dhe padive të bëra kundër ISSH-së dhe DRSSH-së Tiranë në gjykatë, e në media, lidhur me kohën dhe masën e pensionit”. Gjithashtu, gjatë procedurave të shqyrtimit të ankesës, I. I. shtoi edhe pretendimin për diskriminim për shkak të bindjeve politike. Shkaku i diskriminimit është një nga elementët e domosdoshëm për provuar pretendimin për diskriminim. Në radhë të parë shkaku i pretenduar i diskriminimit duhet të jetë një shkak që gëzon mbrojtje nga diskriminimi dhe në radhë të dytë shkaku i pretenduar duhet të provohet.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

B/1 Shkaku i mbrojtur “mosha”.

I. I. pretendon diskriminim për shkak të “moshës”, nga ana e ISSH-së dhe DRSSH-së Tiranë.

Në lidhje me pretendimin e ankuses për diskriminim për shkak të “moshës”, Komisioneri vlerëson se “mosha” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet në bazën ligjore të sipërpërmendur, ankuesi ka lindur në datë 17.12.1946 dhe aktualisht përfiton pension pleqërie.

Në lidhje me shkaku e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë në radhë të parë se shkaku i pretenduar prej saj është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij. E njëjta qasje gjen zbatim edhe kur pretendohet se diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson të provuar shkaku e pretenduar të diskriminimit, nga ana e subjektit ankues, atë të “moshës”.

⁸ “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

B/2 Shkaku i mbrojtur “*bindjet politike*”.

Ankuesi ka pretenduar diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*”, si ish ushtarak, me argumentin se DRSSH, është nisur nga motive politike “*sa më pak pension ushtarakëve*”⁹.

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ligji ka bërë në nenin 3, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme dhe të padrejta që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Bindja politike¹⁰, shpesh është arsye për trajtim diskriminues dhe përfshin qoftë mbajtjen apo mos mbajtjen e saj, si edhe shprehjen e pikëpamjeve ose anëtarësinë në organizata politike, parti politike.

Referuar nenit 1, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ky shkak i pretenduar nga ankuesi konsiderohet si shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD.

Në mbështetje të pretendimit të tij, ankuesi nuk ka dorëzuar asnjë dokument që të vërtetojë anëtarësinë apo aktivitetin politik të tij, të kundërt me drejtuesit e ISSH-së dhe DRSSH-së Tiranë. Për më tepër që ankuesi ka deklaruar se diskriminimi ka ndodhur për shkak të bindjeve politike, duke e lidhur këtë me faktin që ai ka qenë ish ushtarak.

Për sa më sipër, Komisioneri e vlerëson të pabazuar shkakun e “*bindjes politike*” të ankuesit.

B/3 Shkaku i mbrojtur, “*për çdo shkak tjetër*”, (për shkak të ankimeve dhe padive të bëra kundër ISSH-së dhe DRSSH-së Tiranë në gjykatë, e në media, lidhur me kohën dhe masën e pensionit).

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh¹¹.

Neni 1, i ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut

⁹ Referuar në materialin “Kthim përgjigje”, përcjellë me e-mail nga ankuesi më datë 16.04.2025.

¹⁰ Shih linkun në faqen zyrtare të KMD-së: <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

¹¹ Neni 1, i ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër”.

(KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh¹².

Krahas praktikës kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferenat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14 i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

GJEDNJ-ja ka zhvilluar disa shkaqe në kategorinë “*statuse të tjera*”. Sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 14, i KEDNJ-së nuk ndalon të gjitha dallimet në trajtim, por vetëm ato diferenca të bazuara në një karakteristikë personale të identifikueshme, personale, ose “*status*”, me të cilin personat ose grupet e personave janë të dallueshëm nga njëri-tjetri.¹³ Gjykata ka theksuar se fjalës “*shkak/status tjetër*” në përgjithësi i është dhënë një kuptim i gjerë.¹⁴ Interpretimi i këtij nocioni “*nuk është kufizuar në karakteristika që janë personale në kuptimin që ato janë të lindura apo të pandashme*”¹⁵.

Disa karakteristika që GJEDNJ-ja ka njohur se mbrohen në kuadër të “*statuseve të tjera*” janë: Në *Engel dhe të tjerët kundër Vendeve të Ulta*, Gjykata vendosi që një dallim i bazuar në *gradën ushtarake* mund të binte në kundërshtim me nenin 14; në *Larkos kundër Qipros*, Gjykata gjeti shkelje të nenit 14 si rezultat i një *dallimi midis qiramarrësve të shtetit nga njëra anë dhe qiramarrësve të pronarëve privatë nga ana tjetër*; në *Shelley kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata konsideroi se të qenit *i burgosur* mund të binte në nocionin e “*statusit tjetër*” sipas nenit 14; në *Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë*, Gjykata nuk adresoi në mënyrë specifike çështjen e “*statusit tjetër*”, por në gjetjen e një shkelje të nenit 14 dhe nenit 8 pranoi se *statusi si ish oficer i KGB-së* përfshihet në nenin 14; në *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata gjeti shkelje të

¹² Neni 14, i KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”

¹³ Shih: *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 55; *Kjeldsen Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës*, prg 56; *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 61 dhe 70; *Novruk dhe të tjerët kundër Rusisë*, prg. 90.

¹⁴ Shiko: *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 70.

¹⁵ Shiko: *Biao kundër Danimarkës*, aplikimi nr. 38590/10, prg.89.

nenit 14 si rezultat i dallimit që bëhej nga skema e lirimit të parakohshëm bazuar në *kohëzgjatjen e dënimit me burg*.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: *“Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive”*.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se shkak për trajtimin e tij të padrejtë e të pafavorshëm është bërë, për shkak të ankimeve dhe padive të bëra kundër ISSH-së dhe DRSSH-së Tiranë në gjykatë, e në media, lidhur me kohën dhe masën e pensionit, Komisioneri vlerëson se është i provuar dhe krijohet dyshimi i arsyeshëm, bazuar në provat e depozituara në dosje.

Në këtë kontekst, bazuar në deklaratimet, faktet e provat e sjella nga palët, Komisioneri i vlerëson si shkak të mbrojtur nga LMD, referuar si “çdo shkak tjetër¹⁶”.

Një nga përkufizimet e cituara të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDN), është *“veçoria personale”* në bazë të së cilës, personat ose grupet e personave dallohen mes njëri-tjetrit. Sipas GJEDNJ, shkak i diskriminimit është individual, karakteristik për një individ dhe nuk duhet konsideruar si relevant në kuptimin e trajtimit të ndryshëm ose gjatë gëzimit të disa përfitimeve të caktuara¹⁷.

Sa më sipër, Komisioneri do të vijojë analizën e çështjet objekt shqyrtimi, mbështetur në shkakun e *“moshës”* dhe *“të ankimeve dhe padive të bëra kundër ISSH-së dhe DRSSH-së Tiranë në gjykatë, e në media, lidhur me kohën dhe masën e pensionit”*.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe më pak të favorshëm me shkakun e mbrojtur.

Për të vërtetuar faktin se ankuesi është ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e ISSH-sës dhe DRSSH-së Tiranë, duhet të ekzistojë një lidhje objektive shkakësore ndërmjet shkaqeve të mbrojtura nga ligji 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, dhe trajtimit të padrejtë të ankuesit.

Mbështetur në faktet dhe provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, si dhe analizimit të legjislacionit përkatës¹⁸, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e ISSH-së dhe DRSSH-së Tiranë, sa i përket ndalesës së pensionit për muajt Janar dhe Shkurt 2025, duke i cenuar të vetmin burim të ardhurash për përballimin e nevojave jetike.

¹⁶ Për analogji citojmë: Vendimin me nr. 176, datë 02.12.2019, Vendimin nr. 151, datë 28.10.2020 dhe Vendimin nr. 151, datë 11.08.2021, të KMD-së.

¹⁷ Handbook on European Non-discrimination Law’. EU FRA and CoE, 2010.97

¹⁸ Shih Ndarjen III, nëndarja A, të vendimit të KMD.

Por, pavarësisht konstatimit të këtij fakti, ankuesi nuk arriti të provojë dhe dokumentojë se mosha dhe ankimet e bëra kundër ISSH-së dhe DRSSH-së Tiranë në gjykatë, e në media, lidhur me kohën dhe masën e pensionit, kanë shërbyer si shkaqe për të cilat ai është diskriminuar nga ana e ISSH-së dhe DRSSH-së Tiranë.

Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se, bazuar në faktet dhe provat e administruara, pretendimi për diskriminim për shkak të moshës dhe ankimeve të bëra kundër ISSH-së dhe DRSSH-së Tiranë, bazuar vetëm në faktin se ankuesi i posedon ato, është i pamjaftueshëm për të ngritur një prezumim *prima facie* dhe për të krijuar bindjen se kjo sjellje të cilës i është nënshtruar ankuesi është si rezultat i posedimit të këtyre shkaqeve dhe se, në mungesë të tyre, ankuesi do të ishte trajtuar ndryshe.

Konstatimi i trajtimit të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe ekzistenca e shkakut të pretenduar të diskriminimit, nuk të çojnë apriori në përfundimin se jemi përpara një sjellje diskriminuese, për sa kohë që nuk mund të prezumohet lidhja shkakësore, pra se arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji¹⁹.

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse subjektet ankues janë trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me shtetas/individë të tjerë në një situatë të njëjtë apo të ngjashme me të, nevojitet “krahasuesi”.

Në kontekst të sa më sipër, Komisioneri vlerëson, se *apriori* shkakut i pretenduar nga ankuesi, nuk mund të ketë shërbyer si shkak që mund të lidhet me trajtimin e tij të padrejtë apo të pafavorshëm, përse i takon ndalesës së pensionit për muajt Janar dhe Shkurt 2025 nga ana e ISSH-së dhe DRSSH-së Tiranë, pasi është pikërisht gëzimi i këtij shkakut (i moshës së caktuar në ligj për daljen në pension) mbi të cilin ai përfiton pensionin e pleqërisë. Pra, e gjithë kategoria e pensionistëve, që përfitojnë pension pleqërie duhet detyrimisht ta gëzojnë këtë shkak/cilësi, të jenë të moshës të caktuar në ligj, për të përfituar atë.

Sa i përket pretendimit se ankimet e bëra në gjykatë kundër ISSH-së dhe DRSSH-së Tiranë, e në media, lidhur me kohën dhe masën e pensionit, nuk rezulton të kenë shërbyer në mënyrë të drejtpërdrejtë për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të ankuesit, kjo pasi si rezultat i ankimeve dhe vendimeve të gjykatave, nga ana e ISSH-së dhe DRSSH-së, është bërë rilogaritja e masës së pensionit të pleqërisë dhe atij suplementar.

Në bazë të provave të administruara Komisioneri vlerëson se, nuk rezulton të ketë një lidhje shkakësore midis trajtimit të padrejtë, të cilit i është nënshtruar ankuesi dhe shkaqeve të pretenduara prej tij.

¹⁹ Për analogji citojmë vendimet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi: Nr. 50, datë 23.03.2021, Nr. 91, datë 28.05.2021, Nr. 66, datë 07.04.2022, Nr. 82, datë 26.04.2022, Nr. 98, datë 23.05.2022, Nr. 160, datë 15.08.2022.

Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se, sjellja e ISSH-së dhe DRSSH-së ndaj ankuesit mbetet në kuadër paligjshmërie, por nuk provohet që ajo të jetë motivuar nga shkaqet e pretenduara prej tij. Sjellja diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo paligjshmëri përbën diskriminim, pasi për t'u konsideruar i tillë duhet të lidhet domosdoshmërisht me një shkak të mbrojtur të LMD-së.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se pretendimi i subjektit ankues për diskriminim, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, për shkak të “moshës” dhe “ankimeve të bëra në gjykatë e në media kundër ISSH-së dhe DRSSH-së Tiranë, nuk qëndron, pasi nuk rezultoi e provuar që ISSH-së dhe DRSSH-së Tiranë, të kenë shkelur dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit, I. I., nga ana e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, për shkaqet e pretenduara prej tij.
2. Me qëllim parandalimin e situatave të ngjashme, si në rastin e ankuesit, rekomandohet që Instituti i Sigurimeve Shoqërore të ndërmarrë masat e nevojshme për të parashikuar një procedurë konkrete për rillogaritjen e masës së pensioneve, pas vendimeve të gjykatave, në mënyrë që deri në përfundim të tyre, personat që përfitojnë pension pleqërie të njoftohen në çdo hap të saj dhe të mos u ndërpriten të ardhurat që marrin nga pensioni i pleqërisë.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Mosha dhe çdo shkak tjetër “ankimeve të bëra në gjykatë e në media kundër ISSH-së dhe DRSSH-së Tiranë”)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)